



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 96

Tiranë – E premte, 30 qershor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 90, datë 26.6.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10151
Dekret i Presidentit nr. 91, datë 26.6.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10151
Dekret i Presidentit nr. 92, datë 26.6.2023	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 10151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 29.6.2023	Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2023..... 10152
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 29.6.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës së ish-repartit ushtarak për në Aeroportin e Rinasit..... 10154
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 385, datë 29.6.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 663, datë 13.10.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti ‘Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare ‘Qazim Turdiu’”..... 10155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 386, datë 29.6.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 392, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”..... 10156
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 29.6.2023	Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për shërbimet, punët, blerjen e pajisjeve/mjeteve, të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik, materialet për qëllime operationale, përfshirë teknologjinë dhe <i>software</i> -t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të komisionit të veçantë të klasifikimit të këtyre kontratave..... 10157

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 391, datë 29.6.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”	10175
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 29.6.2023	Për rishpërndarje fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për njësitë e qeverisjes qendrore.....	10176
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 29.6.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, të ndryshuar	10177
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 29.6.2023	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Egla Lleshaj	10177
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.6.2023	Për mundësinë e ofrimit jashtë regjimit të punës, të përcaktuar nga punëdhënësi, të shërbimeve të konsultave ambulatorie për pacientë jashtë sistemit të referimit.....	10178
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 29.6.2023	Për lirim nga detyra të kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë	10179
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 87, datë 21.6.2023	Mbi dokumentacionin dhe procedurën për aplikimin, vlerësimin, miratimin dhe refuzimin e kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë.....	10179
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 72, datë 16.6.2023	Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Karavasta Solar” sh.p.k. për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 220 kV të impiantit fotovoltai Karavasta”	10188
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Sali Spahiu.....	10191
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ismail Dervishi.....	10191



DEKRET
Nr. 90, datë 26.6.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë” me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Renis Edmond Muçaj
2. Suada Kujtim Perizi (Dervishi)
3. Manuel Xhemal Dautaj
4. Erjon Muho Kodhima
5. Arlind Aristidh Nikollari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 91, datë 26.6.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë” me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Rea Milajim Zeqaj

2. Edona Skender Kulpa (Vuçaj)
3. Brikena Beqir Hajra (Berisha)
4. Artur Behar Elezi
5. Vinçenzo Jorgji Dheskali

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 92, datë 26.6.2023

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 8, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë” me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Raza Rasim Petrova (Maçi)
2. Riza Haxhi Mulaj
3. Arben Ismail Vrapaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**VENDIM****Nr. 381, datë 29.6.2023****PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2023, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilët lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, është 48 pozicione të kategorisë së mesme dhe të ulët drejtuese.

3. Pozicionet në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil për nivelin e mesëm drejtues, gjithsej 23, si dhe për nivelin e ulët drejtues, gjithsej 25, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

LIDHJA 1**POZICIONET NË TË CILAT MUND KONKURROJNË EDHE KANDIDATË NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL****I. Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm**

1. Drejtor i Drejtorisë së Dokumenteve Biometrike dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme;

2. Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, në Drejtorinë e Përgjithshme

Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes;

3. Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Kulturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, në Ministrinë e Kulturës;

4. Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Kulturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës, në Ministrinë e Kulturës;

5. Drejtor i Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit në Fushën e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Mbetjeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

6. Drejtor i Drejtorisë për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë;

7. Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Projekteve, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;

8. Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Programeve dhe Projekteve të Fondeve IPA dhe Donatorëve të Tjerë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

9. Drejtor i Drejtorisë së Privatizimit dhe Shitjes, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

10. Drejtor i Drejtorisë së Diasporës, në Agjencinë Kombëtare të Diasporës;

11. Jurist në Drejtorinë Juridike të Akteve Prioritare të Këshillit të Ministrave, në Njësinë Ligjore të Vlerësimit dhe Koordinimit të Akteve Prioritare të Këshillit të Ministrave, në Departamentin e Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri;

12. Koordinator në Drejtorinë e Cilësisë dhe Monitorimit, në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA, në Departamentin e Akteve Ligjore Prioritare të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri;

13. Jurist në Departamentin e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, në Kryeministri;

14. Koordinator në Drejtorinë e Anëtarësimit në BE, në Njësinë për Integrimin Evropian, në Departamentin e Politikës dhe Integrimin Evropian, në Kryeministri;



15. Koordinator në Njësinë e Mirëqeverisjes, në Departamentin e Politikës dhe Integritimit Evropian, në Kryeministri;

16. Koordinator në Zyrën e Koordinimit, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

17. Koordinator në Zyrën e Koordinimit, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

18. Drejtor në Drejtorinë e Programimit Strategjik, në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës;

19. Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit;

20. Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror;

21. Drejtor i Drejtorisë së Standardeve, Protokolleve dhe Akreditimit, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror;

22. Drejtor i Drejtorisë së Edukimit në Vazhdim, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror;

23. Drejtor i Drejtorisë së Performancës dhe Sigurimit të Cilësisë, në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror.

II. Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm

1. Sekretar i Përgjithshëm në administratën e Prefektit të Qarkut Durrës;

2. Përgjegjës i sektorit të ndihmës juridike, në Drejtorinë Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;

3. Përgjegjës i Sektorit të Politikës së Sigurisë Evropiane, në Drejtorinë e Politikave NATO dhe BE, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes, në Ministrinë e Mbrojtjes;

4. Përgjegjës i Sektorit të Programeve dhe Strategjive, në Drejtorinë e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit, në Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile;

5. Përgjegjës i Sektorit të Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve IPA, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve në Fushën e Transportit dhe Infrastrukturës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

6. Përgjegjës i Sektorit të Bashkëpunimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

7. Përgjegjës i Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë e Miradministrit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë;

8. Përgjegjës i Sektorit të Inovacionit, në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;

9. Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Arsimit të Lartë, në Drejtorinë e Politikave të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë për Arsimin dhe Sportin;

10. Përgjegjës i Sektorit të Analizave dhe Statistikave, në Drejtorinë e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, në Drejtorinë e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë për Arsimin dhe Sportin;

11. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Fushën Penale, në Drejtorinë e Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë;

12. Përgjegjës i Sektorit të Programimit të Cilësisë dhe Pastërtisë së Mjedisit, në Drejtorinë e Ekonomisë Qarkulluese, në Drejtorinë e Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;

13. Përgjegjës i Sektorit të Ankimimeve (apelim, ekzekutim dhe trajtim i penalteteve), në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;

14. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme dhe Emergjencave Civile, në Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

15. Përgjegjës i Sektorit të Kujdesit Parësor, në Drejtorinë e Politikave të Kujdesit Parësor dhe



Shëndetit Publik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Shëndetësinë, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

16. Përgjegjës i Sektorit të Farmaceutikës, në Drejtorinë e Politikave të Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit për Shëndetësinë, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

17. Përgjegjës i Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

18. Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

19. Përgjegjës i Sektorit të Privatizimit, në Drejtorinë e Privatizimit dhe Shitjes, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike, në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë;

20. Përgjegjës i Sektorit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare të Mbrojtjes Sociale, në Drejtorinë e Politikave të Sigurimeve Shoqërore dhe Marrëveshjeve të Mbrojtjes Sociale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Punësimit, Aftësisimit dhe Sigurimeve Shoqërore, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

21. Përgjegjës i Sektorit të Lidhjes së Kontratave, në Drejtorinë e Administrimit të Pronës Shtetërore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike, në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë;

22. Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave Konkensionare, në Drejtorinë e Koncesioneve, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;

23. Përgjegjës i Sektorit të Digjitalizimit dhe Mikrofilmit, në Drejtorinë e Evidencës, Digjitalizimit dhe Restaurimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;

24. Përgjegjës i Sektorit (labororit) Qendror të Restaurimit, në Drejtorinë e Evidencës, Digjitalizimit dhe Restaurimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;

25. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë.

VENDIM

Nr. 384, datë 29.6.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË AEROPORTIN E RINASIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës së ish-repartit ushtarak për në Aeroportin e Rinasit”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 477 120 (katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 477 120 (katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekësh, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.



8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë - Vorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes

së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë - Vorë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE E TË CILIT SHPRONËSOHET,
PËR REALIZIMIN E PROJEKTTI “REHABILITIMI I RRUGËS SË ISH-REPARTIT USHTARAK PËR NË
AEROPORTIN E RINASIT”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sip. totale m ²	Lloji i pasurisë	TOKE ARË			VLERA TOTALE (LEK)	ADRESA	SHËNIME
								Sip. e shpronësuar	Çmimi (lek/m ²)	Vlera lek			
1	Skënder	Siran	Kulli	1669	42/69	3150	Arc	1065	448	477120	477,120.00	Tiranë (Fushë-Prezë)	Konfirmuar nga ASHK-ja Në favor të BKT-së. Kontratë hipotekare nr. 1925/1016, datë 26.12.2018
Vlera totale								1065	448	477120	477,120.00		

VENDIM

Nr. 385, datë 29.6.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 663, DATË 13.10.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘QAZIM TURDIU’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 663, datë 13.10.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikat 3 dhe 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej “10 833 624 (dhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e katër)” lekësh zëvendësohet me “10 826 810” (dhjetë milionë e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e dhjetë)” lekësh;

b) Në tabelën bashkëlidhur vendimit, pasuria me nr. 9/216, në nr. rendor 1, zëvendësohet me nr. 9/1029, sipas të dhënave të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Tiranë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKET PËR NJË NDRYSHIM NË VKM-në NR. 663, DATE 13.10.2022, “NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJECARE ‘QAZIM TURDIU’”

Nr.	Pronari			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqja e shpronësuar	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Sinan Qazim Boka Hajredin Qazim Boka Menduhie Hush Boka Saimir Rexhep Boka Skënder Qazim Boka Merita Rexhep Boka			8330	9/1029	317.8	Truall	317.8	34,068	10,826,810	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera									10,826,810	

Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave
“Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

VENDIM

Nr. 386, datë 29.6.2023

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 392, DATË 30.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E SPECIALITETEVE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 21, të ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 392, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

a) Kudo në rreshtin 2, pas emërimit “... Orkestra Frymore e FA-së ...” shtohet “... Orkestra Simfonike e FA-së ...” dhe pas fjalëve “... në bandën frymore të FA-së ...” shtohen “... ose në Orkestrën Simfonike të FA-së ...”;

b) Pas rreshtit 4 shtohen rreshtat 5 dhe 6, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

5	Jurist	“ Jurist ” – oficeri, i cili ka përfunduar studimet në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë ose arsimit juridik të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe ushtron detyrën e tij në një pozicion me specialitet të përcaktuar në TOP, si “jurist/këshilltar ligjor”, prej një periudhë jo më pak se 2 (dy) vitesh.
6	Kimist/biolog/fizikant	“ Kimist/biolog/fizikant ” – oficeri/nënoficeri, i cili ka përfunduar studimet e larta ose shkollë tjetër të profilin të shkencave të natyrës, brenda dhe jashtë vendit, ose ka kryer kurset e nevojshme përkatëse dhe ushtron detyrën e tij në një funksion organik në strukturën e FA-së, si pjesë e shërbimit të MADM-së, në përputhje me formimin (diplomën, kursin) e fituar.



VENDIM

Nr. 389, datë 29.6.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR LIDHJEN E KONTRATAVE PËR
SHËRBIMET, PUNËT, BLERJEN E
PAJISJEVE/MJETEVE, TË
PROJEKTUARA POSAÇËRISHT OSE TË
PËRSHTATURA PËR FUSHËN E
SIGURISË DHE/OSE RENDIT PUBLIK,
MATERIALET PËR QËLLIME
OPERACIONALE, PËRFSHIRË
TEKNOLOGJINË DHE *SOFTWARE*-t E
LIDHURA ME KËTO MALLRA, SI DHE
PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E
ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT
TË KOMISIONIT TË VEÇANTË TË
KLASIFIKIMIT TË KËTYRE
KONTRATAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**PJESA I
PËRCAKTIMI I RREGULLAVE PËR
LIDHJEN E KONTRATAVE**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij vendimi është:

a) përcaktimi i rregullave që zbatohen nga Ministria e Brendshme për prokurimin e shërbimeve, punëve, pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik, apo materialet për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, të përjashtuara nga procedurat e prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet në fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik;

b) përcaktimi i përbërjes, mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të komisionit të veçantë të

klasifikimit procedurave, të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni.

2. Qëllimi i këtij vendimi është që t’u sigurojë Ministrisë së Brendshme, institucioneve të varësisë së saj, si dhe ndërmarrjeve, kapitali i të cilave zotërohet në masën mbi 50 (pesëdhjetë) % nga Ministria e Brendshme, furnizimin me shërbime, punë, pajisje/mjete, të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për përdorim në fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik apo materiale për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, në mënyrë të tillë që në asnjë moment të mos cenohet operacionaliteti i organeve ligjzbatuese, siguria dhe rendi publik.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Autoritet kontraktor”**, Ministria e Brendshme dhe organet e saj të varësisë ose shoqëri tregtare, ku Ministria e Brendshme zotëron më shumë se 50 (pesëdhjetë) % të aksioneve ose kuotave.

2. **“Dokumentet e tenderit”**, dokumentet që autoriteti kontraktor vë në dispozicion të kandidatëve dhe ofertuesve të mundshëm për përgatitjen e ofertave, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

3. **“E drejta ekskluzive”**, e drejta e një operatori ekonomik të vetëm, agjencie të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (në vijim “NATO”) ose një vendi anëtar të NATO-s, për të ofruar një mall ose shërbim, objekt të këtij vendimi.

4. **“Fondet publike”** (në vijim “fonde”) janë:

a) çdo vlerë monetare e buxhetit të shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet, sipas këtij vendimi;

b) fonde ndihmë ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare;

c) të ardhura nga shteti, strukturat e tjera të Ministrisë së Brendshme.

5. **“Grupi i punës për hartimin e projektit”**, një strukturë e përkohshme, e ngritur rast pas rasti, me urdhër të autoritetit kontraktor, me qëllim hartimin e projektit.



6. **“Kandidat”**, operatori ekonomik, vendës ose i huaj, që ftohet në një nga procedurat e përcaktuara në këtë vendim.

7. **“Kërkesa për disponueshmëri dhe çmim”**, dokumenti me anë të të cilit autoriteti kontraktor kërkon nëpërmjet vendeve anëtare të NATO-s, agjencive të NATO-s dhe/ose operatorëve ekonomikë, vendës e të huaj, që operojnë me to, disponueshmërinë, si dhe ofertën me çmim të përcaktuar prej tyre.

8. **“Kërkesë e veçantë”**, kërkesa që i dërgohet një vendi të NATO-s ose agjencie të NATO-s nga autoriteti kontraktor, për realizimin e procedurës së prokurimit “shtet me shtet”, në rastin kur nuk ka një marrëveshje të bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe/ose të rendit publik apo marrëveshje teknike përkatëse.

9. **“Kërkesë për prokurim”**, dokumenti i përgatitur nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme ose nga titullari i organit të varësisë ose shoqërisë aksionare, në të cilin përshkruhen karakteristikat teknike kryesore të mallit, shërbimit ose punës. Kërkesa për prokurim nuk përmban vlera financiare të mallrave apo të shërbimeve.

10. **“Komunikimi me shkrim”**, çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, të kopjohen e të komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike.

11. **“Kontraktues”**, operatori ekonomik, i cili furnizon mallrat, shërbimet ose punët, i cili mund të jetë një subjekt vendës ose i huaj, agjenci e NATO-s ose një shtet anëtar i kësaj organizate.

12. **“Kontratë mallrash”**, kontrata që ka objekt furnizimin me pajisje/mjete, të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik apo materiale për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra, si dhe pjesët e tyre të këmbimit.

13. **“Kontratë shërbimi”**, kontrata që ka objekt kryerjen e shërbimeve, të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto shërbime.

Kontrata, që ka si objekt mallra dhe shërbime, vlerësohet si “kontratë shërbimi”, nëse vlera e shërbimeve në kontratë tejkalon atë të mallrave në të njëjtën kontratë.

14. **“Mall”**, çdo gjë materiale që ka vlerë ekonomike, si: pajisjet/mjetet e projektuara posaçërisht ose të përshtatura për fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik, komponentët përbërës të tyre, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me to.

15. **“Marrëveshje kuadër”**, një marrëveshje ndërmjet autoritetit kontraktor dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht, ato që kanë lidhje me çmimin.

16. **“Mënyrë pagese”**, pagesa që mund të kryhet nëpërmjet transfertës bankare ose letërkredisë dokumentare, e përcaktuar në kontratat e lidhura, sipas këtij vendimi.

17. **“Ofertues”**, operatori ekonomik, vendës ose i huaj ose një strukturë shtetërore e vendeve anëtare të NATO-s, agjenci e NATO-s, që paraqet një ofertë në një prokurim të kategorizuar, sipas procedurës së përshkruar në këtë vendim.

18. **“Procedura ‘shtet me shtet’**”, procedura përmes së cilës Ministria e Brendshme blen direkt mallra dhe shërbime nga një vend anëtar i NATO-s ose nga një agjenci e NATO-s.

Do të konsiderohet procedurë prokurimi “shtet me shtet” dhe në rastet kur Ministria e Brendshme autorizon vendin anëtar të NATO-s ose agjencinë e NATO-s për të kryer procedurat e prokurimit në interes të saj, nëpërmjet marrëveshjeve teknike ose nëpërmjet një kërkesë të veçantë për prokurim.

19. **“Procedura konkurruese”**, procedura përmes së cilës mund të marrin pjesë vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor.

20. **“Procedurë me negocim të drejtpërdrejtë”**, procedura përmes së cilës autoriteti kontraktor e përzgjedh vetë operatorin ekonomik dhe negocion me të kushtet e kontratës.

21. **“Proces i prokurimeve në fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik”**, procesi, i cili përfshin gjenerimin e kërkesës për prokurim, hartimin e projektit, realizimin e procedurës së prokurimit, negocimin e kontratës, lidhjen dhe zbatimin e kontratës.

22. **“Projekti”**, dokumenti i përgatitur nga grupi i punës për hartimin e projektit, bazuar në kërkesën për prokurim të miratuar nga komisioni i veçantë i klasifikimit, i cili përfshin qëllimin, referencat ligjore, mënyrën e implementimit, analizën e kostos



dhe vlerën e projektit, procedurën e përzgjedhur të prokurimit, konkluzionet, specifikimet teknike të mallrave dhe të shërbimeve, aspektet logjistike, aspektet e mirëmbajtjes dhe të trajnimit, operatorët e përzgjedhur dhe elemente të tjera teknike, në varësi të projektit.

23. **“Prokurim për mallrat, shërbime dhe/ose punët”**, prokurimi që realizohet nëpërmjet njëres prej procedurave, të përcaktuara në këtë vendim.

24. **“Shpallje e fituesit”**, komunikimi me shkrim i autoritetit kontraktor me operatorin ekonomik, të vlerësuar të suksesshëm në përfundim të procedurave të prokurimit, sipas këtyre rregullave.

25. **“Titullari i autoritetit kontraktor”**, ministri i Brendshëm ose një person i autorizuar prej tij.

KREU II STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Neni 3

Strukturat përgjegjëse të procesit të prokurimeve

1. Strukturat përgjegjëse për realizimin e procesit të prokurimit, sipas objektit të këtij vendimi, që përjashtohen nga rregullat e prokurimeve, sipas ligjit nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, janë, si më poshtë vijon:

- a) titullari i autoritetit kontraktor;
- b) strukturat e gjenerimit të kërkesave për prokurim;
- c) komisioni i veçantë i klasifikimit;
- ç) njësia e prokurimit;
- d) grupi i punës për hartimin e projektit;
- dh) komisioni i vlerësimit të ofertave;
- e) komisioni i negocimit të kontratës;
- ë) komisioni i shqyrtimit të ankesave.

Neni 4

Titullari i autoritetit kontraktor

Titullari i autoritetit kontraktor është subjekti kryesor përgjegjës për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Neni 5

Struktura e gjenerimit të kërkesës për prokurim

1. Struktura e gjenerimit të kërkesës për prokurim është struktura e Ministrisë së Brendshme ose organet në varësi të saj ose shoqërive tregtare, kapitali i të cilave zotërohet në masën mbi 50 (pesëdhjetë) % nga Ministria e Brendshme, që, pas studimit, nëpërmjet titullarit të tyre, gjenerojnë kërkesën për prokurim për mallra e shërbime, në mbështetje të plotësimit të misionit dhe detyrave të tyre funksionale.

2. Struktura gjeneruese e kërkesës për prokurim merr në shqyrtim propozimin për ndryshimet e kërkesës, e cila i është përcjellë nga kryetari i komisionit të veçantë të klasifikimit dhe, pas shqyrtimit e analizimit të saj, bën ndryshimet e nevojshme në kërkesat për prokurim.

Kërkesa e ndryshuar i ridërgohet komisionit të veçantë të klasifikimit për miratim.

Neni 6

Komisioni i veçantë i klasifikimit

Komisioni i veçantë i klasifikimit është strukturë e ngritur pranë Ministrisë së Brendshme, i cili funksionon sipas përcaktimeve të pjesës së dytë të këtij vendimi dhe ka për qëllim klasifikimin ose jo të kërkesave për prokurim, sipas këtij vendimi, të hartuara nga strukturat gjeneruese, si kërkesa për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve, publikimi i të dhënave të të cilave do të cenonte interesat e ligjshëm publikë në fushën e rendit dhe sigurisë publike.

Neni 7

Grupi i punës për hartimin e projektit

1. Grupi i punës për hartimin e projektit ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, i cili përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona dhe ka në përbërje ekspertë të fushës, përfaqësues të strukturës përkatëse për projektet dhe të strukturës gjeneruese të kërkesës për prokurim.

2. Grupi i punës për hartimin e projektit mund të thërrasë për ekspertizë përfaqësues të strukturave të tjera të Ministrisë së Brendshme dhe organeve të varësisë së këtyre ministrive.



3. Grupi i punës është e vetmja strukturë përgjegjëse për përzgjedhjen e operatorëve që do të ftohen dhe përcaktimin e numrit të tyre, duke gjykuar nga domosdoshmëria e sigurimit të mallrave dhe shërbimeve, kompleksitetit dhe/ose konfidentalitetit të projektit.

4. Grupi i punës për hartimin e projektit harton “Kërkesat për disponueshmëri dhe çmim” dhe, pas miratimit nga titullari i autoritetit kontraktor, ua dërgon operatorëve ekonomikë të përzgjedhur në mënyrë elektronike dhe shkresore.

5. Grupi i punës për hartimin e projektit vlerëson çmimet dhe disponueshmërinë e ardhur nga subjektet e interesuara, me qëllim analizën e kostos dhe nxjerrjen e vlerës së projektit.

6. Grupi i punës ka dhe detyrimin e përgjegjësinë e përcaktimit të:

a) procedurës së prokurimit, bazuar në përgjigjet e ardhura nga kërkesat e dërguara për çmim dhe disponueshmëri;

b) rekomandimit për fazat dhe lotet, bazuar në fondet e vëna në dispozicion;

c) mënyrës së implementimit të projektit;

ç) vlerës së projektit, duke përfshirë këtu edhe taksat e aplikueshme, në veçanti tatimin mbi vlerën e shtuar.

d) elementeve të tjera që vlerësohen të nevojshme.

Neni 8

Njësia e prokurimit

1. Njësia e prokurimit është strukturë e përkohshme që ngrihet me urdhër të ministrit të Brendshëm, me qëllim realizimin e procesit të prokurimit, rast pas rasti, dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona, ku, të paktën, njëri është specialist i fushës.

2. Njësia e prokurimit përgjigjet për administrimin e procesit të prokurimit të mallrave dhe të shërbimeve në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim.

Neni 9

Komisioni i vlerësimit të ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave është strukturë e përkohshme, që ngrihet me urdhër të ministrit të Brendshëm, rast pas rasti, dhe përbëhet

nga jo më pak se 3 (tre) persona, ku të paktën, njëri është specialist i fushës.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Në komisionin e vlerësimit të ofertave nuk mund të caktohen anëtarët e njësisë së prokurimit, të grupit të punës për hartimin e projektit dhe personat që kanë përgatitur kërkesën për prokurim.

3. Kryetari i komisionit duhet të përzgjidhet ndërmjet zyrtarëve të lartë drejtues të autoritetit kontraktor dhe është përgjegjës për fillimin e punës menjëherë pas krijimit të komisionit. Në çdo rast, numri i anëtarëve duhet të jetë numër tek.

4. Në rastin e mungesës së personelit të specializuar për objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor mund të punësojë me kontratë specialistë të jashtëm, si anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave. Komisioni kryen detyrat në pavarësi të plotë dhe, nëse kërkon sqarime për dokumentet e tenderit, i merr këto nga njësia e prokurimit.

Neni 10

Komisioni i negocimit të kontratës

1. Komisioni i negocimit të kontratës është strukturë që ngrihet rast pas rasti, me urdhër të autoritetit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona, ku të paktën, njëri është specialist i fushës dhe përgjigjet për hartimin e projektkontratës, negocimin e kushteve të saj me operatorin ekonomik të shpallur fitues dhe ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore, deri në nënshkrimin e saj.

2. Në komisionin e negocimit të kontratës nuk mund të caktohen anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

KREU III

RREGULLAT E PËRGJITHSHME PËR LIDHJEN E KONTRATAVE

Neni 11

Klasifikimi i kontratave

1. Kontratat për prokurimin e punëve, mallrave dhe të shërbimeve, sipas përcaktimit të bërë në këtë vendim, klasifikohen si kontrata të një rëndësie të



veçantë, në kontrata njëvjeçare dhe në kontrata shumëvjeçare.

2. Kontrata njëvjeçare janë kontratat, të cilat kërkojnë financim vetëm në 1 (një) vit financiar dhe miratohen nga autoriteti kontraktor.

3. Kontratat shumëvjeçare janë kontratat, financimi i të cilave shtrihet në më shumë se 1 (një) vit financiar, realizimi i të cilave kryhet brenda një afati jo më shumë se 4 (katër) vjet, dhe miratohen nga autoriteti kontraktor;

Neni 12

Llogaritja e vlerës së projektit dhe e vlerës limit të kontratës

1. Vlera e projektit përfshin vlerën e mallit apo të shërbimit që parashikohet të blihet dhe kostot e parashikueshme që lidhen me të.

2. Vlera limit e kontratës është shuma totale, e pagueshme në lekë ose në valutë të huaj, pa tatimin mbi vlerën e shtuar.

3. Vlera e tatimit mbi vlerën e shtuar llogaritet si zë më vete dhe, kur është e zbatueshme, i shtohet vlerës së ofertës fituese për llogaritjen e vlerës totale të kontratës që do të lidhet.

4. Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar.

5. Në rastet e kontratave të mallrave dhe shërbimeve, përmes qirasë, vlera limit e kontratës llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve gjatë të cilave do të zgjasë kontrata.

6. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të ketë parasysh:

a) krahasueshmërinë me çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë autoriteti kontraktor dhe strukturat vartëse të tij;

b) çmimet e kontratave aktuale, të realizuara nga ministrinë homologe dhe strukturat e tyre të varësisë të vendeve anëtare të NATO-s, agjenci të NATO-s, për mallra dhe shërbime të tilla apo të ngjashme;

c) deklaratimet në faqet zyrtare të NATO-s, të vendeve anëtare të NATO-s, agjenci të NATO-s ose të subjekteve që operojnë me këto vende;

ç) koston dhe disponueshmërinë e ministrive homologe, strukturave vartëse të tyre, agjencive të NATO-s dhe/ose subjekteve e operatorëve ekonomikë, vendës ose të huaj, që operojnë me to,

të ofruara prej tyre.

7. Çmimet merren në formë krahasimore ose si një mesatare e ofertave të mbledhura, duke bërë llogaritjet e nevojshme në përshtatshmëri me objektin e prokurimit.

8. Analiza e kostos bëhet në bazë të konceptit kosto-efektivitet.

Neni 13

Kriteret për vlerësimin e ofertës

1. Për mallrat apo shërbimet që kanë standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët.

2. Për kontrata komplekse dhe të një natyre të veçantë që, përveç çmimit për mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetin kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetja teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin, mund të përdoret kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme.

3. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se 1 (një), pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 (pesëdhjetë) pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 (njëqind) pikë. Për kriteret vlerësuese duhen përcaktuar pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet e tenderit.

Neni 14

Dokumentet e tenderit

1. Njësia e prokurimit harton dokumentet e tenderit, sipas llojit të procedurës së prokurimit. Dokumentet e tenderit minimalisht duhet të përfshijnë:

a) informacionin e përgjithshëm;

b) informacionin specifik, që ka lidhje me objektin e kontratës dhe llojin e procedurës, i cili plotësohet, në çdo rast, nga autoriteti kontraktor.

Dokumentet duhet të jenë gjithmonë në dispozicion të çdo operatori, të cilit i është ofruar kërkesa për pjesëmarrje në tender.

2. Informacioni i përgjithshëm përfshin:



- a) njoftimin e kontratës dhe të ftesës për ofertë;
- b) udhëzimet për kandidatët/ofertuesit;
- c) formularin e ofertës;
- ç) kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes;
- d) formularin e sigurimit të ofertës;
- dh) formularin e sigurimit të kontratës;
- e) formularin e njoftimit të klasifikimit;
- ë) formularin e njoftimit të fituesit;
- f) formularin e skualifikimit të ofertuesve/kandidatëve;
- g) formularin e ankesës;
- gj) kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të kontratës.

Dokumentet e mësipërme nuk aplikohen në rastin e procedurës së prokurimit “shtet me shtet”.

3. Informacioni specifik përfshin:

- a) Për kontratat e mallrave:
 - i. specifikimet teknike;
 - ii. grafikun e livrimit;
 - iii. kualifikimet e veçanta dhe kriteret e shpalljes së fituesit.
- b) Për kontratat e shërbimeve:
 - i. termat e referencës;
 - ii. grafikun e realizimit;
 - iii. kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit.
- c) Për kontratat e punëve:

- i. specifikimet teknike;
- ii. grafikun e livrimit;
- iii. kualifikimet e veçanta dhe kriteret e shpalljes së fituesit;

4. Krahas dokumentacionit të mësipërm, subjekteve pjesëmarrëse mund t’u vihet në dispozicion edhe ndonjë informacion tjetër që gjykohet i nevojshëm, në përshtatshmëri me objektin e kontratës. Në çdo rast, informacioni që u jepet operatorëve ekonomikë duhet të jetë i njëjtë për të gjithë.

Neni 15

Informacioni i përgjithshëm

1. Njoftimi i kontratës dhe ftesës për ofertë

a) Njoftimi i kontratës dhe ftesa për ofertë u bëhet operatorëve ekonomikë të përzgjedhur, në mënyrë direkte ose nëpërmjet përfaqësuesve të akredituar në Republikën e Shqipërisë dhe përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në

mënyrë që t’i lejojë kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat e tyre.

b) Njoftimi i kontratës për mallrat, punët dhe shërbimet që prokurohen, sipas këtij vendimi, nuk u nënshtrohet njoftimeve publike.

c) Njoftimi i kontratës përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për t’i lejuar operatorët ekonomikë të vendosin nëse do të marrin pjesë ose jo në procedurat e prokurimit.

ç) Ky informacion përfshin:

- i. emrin dhe adresën e autoritetit kontraktor dhe të personit/ave përgjegjës për procedurën;
- ii. objektin;
- iii. referencën e njoftimit;
- iv. procedurën e prokurimit;
- v. fondin e përlogaritur;
- vi. kohëzgjatjen e kontratës;
- vii. një përshkrim të shkurtër të kontratës dhe/ose lotet, nëse ato përdoren;
- viii. kriteret e shpalljes së fituesit;
- ix. vendin, datën dhe orën për dorëzimin e ofertave;
- x. vendin, datën dhe orën për hapjen e ofertave;
- xi. gjuhën/gjuhët e ofertave dhe të dokumenteve;
- xii. informacionin e mëtejshëm që është konsideruar si i dobishëm nga autoriteti kontraktor.

2. Udhëzimet për kandidatët/ofertuesit

a) Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, duke përfshirë dhe shpjegimet, se:

- i. pjesëmarrësit në procedurën e prokurimit duhet të përdorin dokumentet e tenderit, pa bërë asnjë ndryshim;
- ii. nëse parashikohet një vizitë në terren/objekt, atëherë të gjithë pjesëmarrësit në tender duhet të kenë mundësi të barabarta për të vëzhguar terrenin e punës/ekzekutimit;
- iii. mund të organizohet edhe një konsultë paraprake, ku çdo kandidat të mund të kërkojë sqarime për ndonjë paqartësi që i lind gjatë përgatitjes së dokumenteve;

iv. kërkesat për sqarime duhet të paraqiten me shkrim ose *e-mail* dhe përgjigjet përkatëse të autoritetit kontraktor duhet t’u dërgohen, pa përjashtim, të gjithë operatorëve ekonomikë, që janë përcaktuar nga autoriteti kontraktor;

v. çdo ndryshim në dokumentet e tenderit duhet t’i bëhet i njohur çdo operatori ekonomik kandidat.

3. Formulari i ofertës



a) Formulari i ofertës përmban vlerën e ofertës dhe konfirmimin e ofertuesit, se:

i. e ka shqyrtuar dhe pranuar përmbajtjen e dokumenteve të tenderit;

ii. autorizon autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/dokumentet që i bashkëlidhen ofertës;

iii. do të përmbushë kontratën, pa asnjë rezervë ose kufizim, në përputhje me projektin, specifikimet teknike apo termat e referencës, si dhe me vlerën e deklaruar në ofertë.

b) Formularit të ofertës i bashkëlidhet lista e çmimeve e detajuar për elementet përbërëse që argumentojnë çmimin e plotë, kur është e aplikueshme. Ofertuesi duhet të deklarojë se oferta mbetet e vlefshme dhe e pandryshuar, deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë nga data e fundit e dorëzimit.

4. Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes

Ky dokument përmban listën e dokumentacionit ligjor dhe administrativ të kandidatëve/ofertuesve, të kërkuar nga autoriteti kontraktor, me të drejtën për të marrë pjesë në procesin e prokurimit.

5. Formulari i sigurimit të ofertës:

a) ky formular shërben si masë mbrojtëse për autoritetin kontraktor, në rastet e ofertave të papërgjegjshme apo të tërheqjes së ofertave në mënyrë të njëanshme, pas hapjes së tyre apo refuzimit të nënshkrimit të kontratës;

b) sigurimi i ofertës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari;

c) ofertuesit ose kandidatët e kualifikuar duhet të paraqesin sigurimin e ofertës, në vlerën 2 (dy) % të vlerës limit, të përcaktuar në dokumentet e tenderit;

ç) sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave; megjithatë, në dokumentet e tenderit mund të parashikohet një periudhë e ndryshme vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës;

d) lëshuesi i sigurimit të ofertës duhet të mos vendosë asnjë kusht për pagimin dhe duhet të paguajë shumën, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës zyrtare të autoritetit kontraktor;

dh) autoriteti kontraktor duhet t'ua kthejë apo t'ua lirojë ofertuesve sigurimin e ofertës, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

6. Formulari i njoftimit të fituesit:

a) Pas miratimit të raportit përmbledhës për procedurën nga titullari i autoritetit kontraktor, ofertuesi i suksesshëm njoftohet me shkrim për pranimin e ofertës dhe për lidhjen e kontratës.

b) Njoftimi duhet të përmbajë:

i. referencën e procedurës;

ii. emrin dhe adresën e saktë të ofertuesit të shpallur fitues;

iii. përshkrimin e mallrave dhe/ose shërbimeve që do të blihen;

iv. kohëzgjatjen e kontratës dhe çmimin/vlerën e kontratës;

v. emrat dhe çmimet/vlerën e ofertuesve të tjerë;

vi. kërkesën që kontrata të nënshkruhet brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, në rastin kur është zhvilluar tender konkurrues ose i drejtpërdrejtë me subjektin ekonomik, me kusht që të jetë bërë sigurimi i saj.

7. Formulari i njoftimit të klasifikimit:

a) Në bazë të ofertave të pranuara, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve me shkrim ose në rrugë elektronike.

b) Njoftimi duhet të përmbajë:

i. referencën e procedurës;

ii. emrin e saktë të ofertuesve të kualifikuar;

iii. përshkrimin e punëve, mallrave dhe/ose shërbimeve që do të blihen;

iv. ofertat ekonomike të kualifikuara dhe klasifikimin e tyre.

8. Formulari i skualifikimit të ofertuesve

Ofertuesi/t e skualifikuar njoftohen me shkrim për arsyet e skualifikimit të ofertës/ofertave të paraqitura, bazuar në kërkesat e këtij vendimi.

9. Formulari i sigurimit të kontratës:

a) sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës;

b) ofertuesi, i përzgjedhur si fitues, duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10 (dhjetë) % të vlerës së saj;

c) sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari;



c) gjatë ekzekutimit, nëse janë parashikuar pagesa periodike, sipas grafikut të zbatimit të kontratës, kontraktori mund të kërkojë reduktimin e përqindjes së vlerës së sigurimit në mënyrë përpjesëtimore, por jo më pak se 25 (njëzet e pesë) % të vlerës korresponduese të kontratës;

d) nëse ofertuesi i përzgjedhur nuk dorëzon sigurimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar nga palët, atëherë autoriteti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës dhe rishpall procedurën.

10. Formulari i ankesës

Formulari i ankesës u shërben operatorëve të interesuar ekonomikë për dorëzimin e ankesës administrative, për veprimet apo mosveprimet e autoritetit kontraktor. Ky formular përmban udhëzimet e nevojshme për plotësimin dhe nënshkrimin e tij.

11. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës

Ky dokument përkufizon tërësinë e furnizimeve që do të kryhen për punët, mallrat apo shërbimet, të drejtat dhe detyrimet, ndërmjet autoritetit kontraktor dhe kontraktorit, si dhe detyrimet që lidhen me ekzekutimin, mbikëqyrjen dhe administrimin e kontratës.

Kushtet përfundimtare të kontratës do të negociohen me operatorin e shpallur fitues, në fazën e negocimit të kontratës.

Neni 16

Informacion specifik

1. Kontratat e mallrave:

a) Kontratat e mallrave duhet të pasqyrojnë specifikimet teknike, sasinë e mallrave që do të livrohen për të plotësuar nevojat e autoritetit kontraktor dhe grafikun e livrimit, në të cilin përcaktohet qartë mënyra dhe afatet përfundimtare për livrimin e mallrave.

b) Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, si më poshtë vijon:

i. specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave që do të prokurohen. Ato duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit;

ii. specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët pjesëmarrës;

iii. specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu

referuar standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

c) Për t'u garantuar për cilësinë, autoriteti kontraktor mund t'i kërkojë operatorit ekonomik dëshmi të originalitetit të mallit, testet përkatëse dhe ndonjë element tjetër, të cilin ai e vlerëson të nevojshëm. Në raste të veçanta, ai mund të kërkojë dhe mostra të mallit, të cilat trajtohen në konfidencialitet.

2. Kontratat e shërbimeve

Natyra e shërbimeve që prokurohen, sipas këtij vendimi, duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.

3. Kërkesa të veçanta për kualifikim për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve:

a) Autoriteti kontraktor mund të kërkojë dëshmi të furnizimeve me mallra/shërbime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare.

Dëshmia e realizimit të suksesshëm të furnizimeve duhet të provohet me anë të certifikatave/dëshmime ose të dokumenteve të tjera, të lëshuara nga përfituesi i mallrave/shërbimeve, certifikime speciale, sipas rëndësisë dhe specifikës së kontratës, të cilat mund të jenë të NATO-s dhe organizmave të tjerë kombëtarë ose ndërkombëtarë.

b) Për kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojnë kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse, kopje të deklaratave të xhiros vjetore dhe raportet e menaxhimit, të certifikuara nga një auditues ligjor i licencuar.

c) Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe llojet e procedurave. Ato aplikohen veçanërisht në kushtet e zhvillimit të një procedure konkurruese.

4. Kriteret për vlerësimin e ofertës

a) Kriteret për vlerësimin e ofertës janë:

i. çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar. Kontrata do t'i akordohet atij ofertuesi që ka ofruar çmimin më ulët të ofertës;

ii. oferta ekonomikisht më e favorshme.

b) Për kriteret vlerësuese në rastin e dytë, në dokumentet e tenderit duhen përcaktuar qartë elementet, formula që do të zbatohet dhe çdo detaj i nevojshëm për vlerësimin e ofertave.



KREU IV LLOJET DHE PËRZGJEDHJA E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Neni 17

Llojet e procedurave të prokurimit

Autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesve të kontratave për mallra dhe shërbime, sipas këtij vendimi, zbaton procedurat e mëposhtme:

1. Procedurën konkurruese.
2. Procedurën me negociim të drejtpërdrejtë me një operator ekonomik.
3. Procedurën “shtet me shtet”.

Neni 18

Procedura konkurruese

1. Procedura konkurruese mund të përdoret për të gjitha kontratat për furnizimin me shërbime, punë pajisje/mjete, të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për përdorim në fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik, apo materiale për qëllime operationale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra.

2. Në këtë procedurë marrin pjesë vetëm operatorët ekonomikë të përzgjedhur nga autoriteti kontraktor. Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë bëhet në bazë të natyrës së kontratës.

3. Njoftimi i kontratës u dërgohet subjekteve që janë studiuar si kandidatë të mundshëm dhe operatorëve të tjerë, kur gjykohet e nevojshme nga titullari i autoritetit kontraktor. Ky njoftim përmban informacionin e nevojshëm, sipas përcaktimit të bërë për këtë fazë të procesit.

4. Për caktimin e afateve për dorëzimin e ofertave, autoriteti kontraktor merr në konsideratë kompleksitetin e objektit të prokurimit dhe kohën e nevojshme për hartimin e ofertave.

Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje do të jetë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e dërgimit të njoftimit të kontratës.

5. Autoriteti kontraktor duhet të ftojë jo më pak se 2 (dy) operatorë ekonomikë, në çdo rast, pa penguar konkurrencën e lirë.

6. Pas dorëzimit të ofertës nga operatorët ekonomikë, të cilët janë përzgjedhur për të marrë pjesë në procedurën konkurruese, autoriteti kontraktor bën vlerësimin e ofertave, duke

përcaktuar ofertën më të leverdisshme, sipas kriterit të përcaktuar për vlerësim.

7. Në rast se një ose disa oferta konsiderohen të pavlefshme/skualifikuara dhe mbetet vetëm një ofertë e vlefshme ose oferta e vlefshme është dorëzuar e vetme, autoriteti kontraktor e analizon atë dhe, në rast se e konsideron ofertë të arsyeshme, e shpall fitues dhe urdhëron fillimin e procesit të negociimit.

8. Në rast se asnjë nga subjektet pjesëmarrëse në tender nuk plotësojnë kërkesat dhe ofertat konsiderohen të pavlefshme, procedura anulohet dhe rihapet.

Neni 19

Procedura me negociim të drejtpërdrejtë

1. Procedura me negociim të drejtpërdrejtë është procedura përmes së cilës autoriteti kontraktor ka arsye të përzgjedhë vetëm një operator ekonomik dhe të negociojë me të kushtet e kontratës.

2. Autoriteti kontraktor mund të realizojë procedurat e prokurimit me negociim të drejtpërdrejtë për të gjitha llojet e kontratave, në rastet kur ekziston të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) Kur, për arsye që lidhen me të drejtat ekskluzive ose të drejtat e autorit, kontrata nuk mund të ekzekutohet, përveçse nga një operator i vetëm ekonomik, i cili mund të jetë dhe subjekti i autorizuar/licencuar nga prodhuesi/autori, për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë rast, do të kërkohej autorizimi/licenca përkatëse.

b) Kur, në përgjigje të kërkesës për çmim dhe disponueshmëri, adresuar të paktën 2 (dy) operatorëve ekonomikë që operojnë në fushën, objekt të prokurimit, rezulton vetëm një subjekt i konsideruar si kandidat i mundshëm.

c) Në rast se mallrat, shërbimet ose punët e kërkuara janë vijim i investimeve të mëparshme të pajisjeve/mjeteve, të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto kërkesa. Në këtë rast, afati i përdorimit të atyre ekzistuese nuk duhet të ketë kaluar 50 (pesëdhjetë) % të jetëgjatësisë së tij, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

ç) Në rast se blerja e mallrave është e njëjtë me ato ekzistuese në përdorim të organeve në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe ndryshimi i furnizimit



me tipa të ndryshëm do të rezultojë me mallra me karakteristika të ndryshme teknike, që çojnë në vështirësi operacionale, teknike, mirëmbajtjeje dhe trajnimi kompleks të personelit, duke cenuar në këtë mënyrë unifikimin e mallrave.

d) Në rastin e shtesës së kontratave të prokurimit të punëve, mallrave ose shërbimeve, nëse nevoja për mallra/shërbime/punë shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga autoriteti kontraktor dhe që nuk mund të ndahen teknisht ose ekonomisht nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative ose kosto të mëtejshme për autoritetin kontraktor, por që janë të nevojshme për përfundimin e kontratës fillestare. Shtesa e kontratës nuk mund të tejkalojë 20 (njëzet) % të vlerës së kontratës fillestare.

dh) Në raste urgjencash, kur cenohet niveli i gatishmërisë dhe operacionalitetit të strukturave të varësisë së Ministrisë së Brendshme.

3. Për caktimin e afateve për dorëzimin e ofertës, autoriteti kontraktor merr në konsideratë kompleksitetin e objektit të prokurimit dhe kohën e nevojshme për realizimin e kontratës.

Neni 20

Procedura “shtet me shtet”

1. Procedura “shtet me shtet” realizohet, për:

- a) furnizimin me pajisje të klasifikuara;
- b) punë dhe shërbime që lidhen drejtpërdrejt me këto pajisje;
- c) punë dhe shërbime që, për arsye sigurie, përfshijnë/kërkojnë dhe/ose përmbajnë informacion të klasifikuar.

2. Procedurat “shtet me shtet” mund të realizohen në një nga format e mëposhtme:

a) drejtpërdrejt me një vend anëtar të NATO-s ose me një agjenci të NATO-s;

b) nëpërmjet dhënies së autorizimit një vendi anëtar të NATO-s ose agjencie të NATO-s për të kryer procedurat e prokurimit, nëpërmjet marrëveshjeve teknike ose nëpërmjet një kërkesë të veçantë për prokurim.

3. Procedura e drejtpërdrejtë me vendin anëtar ose agjencinë e NATO-s është procedura përmes së cilës autoriteti kontraktor prokuron mallra dhe shërbime te një ministri homologe ose struktura vartëse të saj ose agjenci e NATO-s, me kushtet, çmimet e standardet që ato zbatojnë për strukturat e tyre.

4. Procedura me dhënie autorizimi një vendi/agjencie të NATO-s është procedura përmes së cilës autoriteti kontraktor autorizon një ministri homologe ose strukturë vartëse të saj apo dhe një agjenci të NATO-s për të realizuar prokurimin në interes të organeve të varësisë së Ministrisë së Brendshme, me procedurën, kushtet, çmimet e standardet, që ato zbatojnë për strukturat e tyre të sigurisë. Në këtë rast, autoriteti kontraktor transferon paraprakisht fondin financiar të shteti përkatës ose agjencia e NATO-s, pas autorizimit të marrë nga ministria përgjegjëse për financat.

5. Procedurat “shtet me shtet” mund të bëhen me kontrata njëvjeçare ose kontrata disavjeçare.

6. Procedura e prokurimit “shtet me shtet” përfshin nënshkrimin e marrëveshjes teknike ose, në mungesë të saj, dërgimin e kërkesës së veçantë vendit/agjencisë së NATO-s, të cilave u delegohet realizimi i procedurës së prokurimit, sipas sistemit të tyre të prokurimit. Ky lloj prokurimi mund të realizohet në këto raste:

a) kur testimi i mallit të caktuar kërkon analizë teknike komplekse dhe organet e varësisë së Ministrisë së Brendshme nuk kanë mundësi ta kryejnë atë;

b) kur nuk ka një ekspertizë të mjaftueshme /nevojshme për objektin e prokurimit;

c) kur një formë tjetër prokurimi, e përcaktuar në këtë vendim ka dështuar ose ka argumente të qëndrueshme që dëshmojnë për mungesë leverdie, për shkak të çmimit ose të cilësisë së dobët të mallit;

ç) kur ekzistojnë kontrata të mëparshme të kësaj kategorie, prokurime “shtet me shtet” dhe ajo vlerësohet më e leverdishme sesa blerja e drejtpërdrejtë të një subjekti ekonomik, që operon me këtë shtet ose me shtete të tjera;

d) kur ka një nevojë urgjente, për shkaqe jashtë kontrollit apo parashikimit të autoritetit kontraktor, që kanë të bëjnë me fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, dhe kur afati kohor limit për procedura të konkurrimit nuk mund të realizohet dhe ekzistojnë rrethana të besueshme. Rrethanat e krijuara, në asnjë rast nuk duhet të përdoren për investimet komplekse, të cilat zgjasin më shumë se një vit buxhetor;

dh) në raste urgjencash, kur cenohet niveli i gatishmërisë dhe operacionalitetit të strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës ose organeve të tjera të sigurisë;



e) kur nuk mund të gjenden operatorë ekonomikë në treg;

ë) kur shteti/agjencia e NATO-s përballon një pjesë të mallit ose shërbimit në vlerë monetare ose në natyrë, por jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) % e vlerës totale të mallit ose shërbimit që kërkohet të prokurohet.

7. Në procedurën “shtet me shtet” autoriteti kontraktor ndjek këta hapa:

a) pas hartimit të kërkesës për prokurim nga struktura gjeneruese dhe klasifikimit të saj nga komisioni i veçantë i klasifikimit, grupi i punës për hartimin e projektit harton projektin teknik me të gjithë informacionin e mundshëm, duke përcaktuar kërkesa sa më të plota e të sakta tekniko-operacionale;

b) projekti teknik dhe rekomandimi për llojin e procedurës “shtet me shtet” i dërgohen titullarit të autoritetit kontraktor për miratim;

c) me miratimin nga titullari, njësia përgjegjëse për prokurimin i drejtohet vendit anëtar të NATO-s ose agjencisë së saj e negocion me të kushtet e projektit, në të cilën përcaktohen edhe afatet e dërgimit nga kjo e fundit të ofertës teknike dhe ekonomike;

ç) autoriteti kontraktor e vlerëson këtë ofertë dhe vendos nëse do të vijojë apo jo me nënshkrimin e saj.

KREU V MARRËVESHJA KUADËR

Neni 21 Rregulla të përgjithshme

1. Marrëveshja kuadër përdoret kur autoriteti kontraktor e di me siguri objektin që do të prokurojë, por nuk di sasinë, kohën e livrimit të mallit/ofrimit të shërbimit ose kushte të tjera të kontratës.

2. Marrëveshja kuadër përmban listën e mallrave/shërbimeve, si dhe termat dhe kushtet e marrëveshjes dhe është e detyrueshme për zbatim nga palët.

3. Autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë një sasi të caktuar mallrash/shërbimesh të përfshira në marrëveshje, por, në çdo rast, gjatë kohëzgjatjes së saj nuk lejohet të blejë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra/shërbime të mbuluara nga marrëveshja kuadër.

4. Marrëveshja kuadër mund të lidhet vetëm pasi autoriteti kontraktor të ketë kryer një nga procedurat e prokurimit të parashikuara në këtë vendim.

5. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër, duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

6. Në rastin kur autoriteti kontraktor e ka të pamundur të përcaktojë sasinë e mallit ose të shërbimit, mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese, duke u bazuar në çmimin për njësi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor planifikon me përfaqësi sasinë dhe vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër, bazuar në eksperiencat e mëparshme, me qëllim jo vetëm orientimin e operatorëve ekonomikë, por edhe hartimin e kriterëve për kualifikimin apo kërkesave të tjera, të cilat lidhen përpjesëtimisht me fondin limit.

7. Fondi limit, me të cilin autoriteti kontraktor do të shpallë procedurën e prokurimit, është vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Hartimi i kriterëve të veçanta për kualifikim, si kapacitetet teknike ekonomike apo kriterë të tjera, të cilat lidhen me fondin, do të përllogariten mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen.

8. Në rastin kur autoriteti kontraktor vendos të vlerësojë me “çmim për njësi”, atëherë, përveç vlerës së pritshme të kontratave, do të përllogarisë edhe shumatoren e çmimeve për njësi, e cila duhet të publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave, fondin limit, në njoftimin e kontratës.

Në këtë rast, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim nga autoriteti kontraktor.

9. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër akordohen brenda kufijve dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen kuadër.

10. Në kontratat e bazuara në marrëveshjen kuadër nuk mund të bëhen ndryshime të kushteve për të cilat është lidhur marrëveshja.

11. Nëse nevojat e autoritetit kontraktor për karakteristikat e mallit ose shërbimit ndryshojnë,



atëherë autoriteti kontraktor duhet të prokurojë një marrëveshje kuadër të re.

Neni 22

Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër

Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më shumë se 4 (katër) vjet.

Neni 23

Llojet e marrëveshjeve kuadër

1. Marrëveshja kuadër mund të lidhet me një ose disa operatorë ekonomikë.

2. Në marrëveshjet kuadër me një operator ekonomik, gjatë zbatimit të saj, këtij të fundit i kërkohet të përgatisë ofertën e tij vetëm në lidhje me kushtet për të cilat është rënë dakord paraprakisht në marrëveshjen kuadër.

3. Në çdo rast, dhënia e kontratave do të bëhet pa rihapur konkurrimin, duke u bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër.

4. Në kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, të lidhura me disa operatorë ekonomikë, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë në dokumentet e tenderit, kushtet që do të zbatohen për dhënien e kontratave brenda marrëveshjes kuadër.

5. Marrëveshjet kuadër me disa operatorë ekonomikë duhet të lidhen me të paktën 3 (tre) operatorë ekonomikë, nëse ato i kanë përmbushur të gjitha kriteret e përzgjedhjes. Në rast të kundërt, autoriteti kontraktor mund të lidhë marrëveshje kuadër me ato operatorë ekonomikë që i kanë përmbushur të gjitha kriteret, me kusht që të jenë të paktën dy.

6. Në rast të përdorimit të marrëveshjeve kuadër me disa operatorë ekonomikë, autoriteti kontraktor, për të lidhur kontratë brenda marrëveshjes kuadër, duhet të rihapë konkurrimin.

7. Autoriteti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.

8. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë duhet të përcaktojë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.

9. Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese gjatë rihapjes së konkurrimit mund të jenë të njëjta si ato të marrëveshjes kuadër ose autoriteti kontraktor mund të përdorë kriteret e tjera, me kusht që ato të jenë të përcaktuara në dokumentet fillestare të marrëveshjes kuadër.

KREU VI

ZHVILLIMI I PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Neni 24

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

1. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e procedurave të prokurimit, si dhe për ndarjen e qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe të atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit e të përzgjedhjes së fituesit.

2. Përpara emërimit të një nëpunësi prokurimi, duhet të mbahen parasysh kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

3. Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar prej tij të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes.

4. Njësia e prokurimit ka dhe përgjegjësinë për mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen dokumenteve të tenderit, si:

a) kërkesat për prokurim;

b) vendimi i komisionit të veçantë të klasifikimit;

c) miratimi i autoritetit kontraktor;

ç) standardet e NATO-s, kombëtare e ndërkombëtare;

d) dokumente të tjera në përshtatshmëri me veçorinë e procedurës së prokurimit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve.

5. Kur sigurohen fondet dhe ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar prej tij miraton



urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë të paktën:

- a) objektin e prokurimit;
- b) përbërjen e njësisë së prokurimit;
- c) vlerën limit të kontratës;
- ç) llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj.

Neni 25

Hartimi i dokumenteve të tenderit

1. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e dokumenteve të tenderit për të cilat mbahet procesverbal. Dokumentet e tenderit dhe procesverbali i mbajtur për hartimin e tyre nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit.

2. Në rastet e kontratave komplekse ose të kontratave që kërkojnë njohuri të veçanta, teknike a juridike, autoriteti kontraktor mund të punësojë specialistë të jashtëm ose kontraktorë, për të ndihmuar njësinë e prokurimit në hartimin e dokumenteve të tenderit.

3. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor përdor dokumentet standarde të tenderit që përdoren në procedurat e prokurimit publik, duke i përshtatur me kërkesat e këtij vendimi.

4. Pas hartimit të dokumenteve të tenderit, titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar, në përshtatshmëri me tipin e procedurës së prokurimit, miraton njoftimin e kontratës.

5. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për lëshimin e një kopjeje të dokumenteve të tenderit për çdo operator ekonomik të miratuar nga autoriteti kontraktor. Nëse një operator ekonomik kërkon ndonjë sqarim, njësia e prokurimit ia komunikon këtë me shkrim.

6. Nëse, pas njohjes me dokumentet e tenderit, ndonjë ofertues i mundshëm kërkon sqarime për dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 (pesë) ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 (tri) ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë

operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

7. Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

8. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës nga 5 (pesë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

Neni 26

Dorëzimi i ofertave

1. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit, brenda afatit kohor të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e ofertave.

2. Çdo ofertë e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktor nuk shqyrtohet nga komisioni dhe i kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një zarf të mbyllur dhe të vulosur, i cili duhet të përmbajë kualifikimet ligjore të kandidatit/ofertuesit, ofertën teknike dhe ofertën ekonomike.

3. Oferta paraqitet sipas përcaktimit në dokumentet e tenderit. Mosparaqitja, sipas përcaktimit apo mungesa e çdo elementi në dokumentet e tenderit e bën ofertën të pavlefshme. Në këtë rast, oferta skualifikohet, por zarfi nuk i kthehet ofertuesit.

4. Dokumentet e tenderit mund të dorëzohen nga operatorët ekonomikë në formë shkresore ose elektronike. Dorëzimi në formë elektronike aplikohet në rastet kur dokumentet e tenderit nuk përmbajnë informacion të klasifikuar, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Ofertat në rrugë elektronike dorëzohen në një adresë elektronike të posaçme të krijuar nga autoriteti kontraktor vetëm për këtë qëllim.

Ofertat elektronike hapen njëkohësisht me ofertat e dorëzuara me shkrim në vendin, datën dhe orën e përcaktuar në dokumentet e tenderit.



Neni 27

Hapja dhe vlerësimi i ofertave

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave hap dhe lexon ofertat në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi.

2. Anëtarët e njësisë së prokurimit, që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve të tenderit, janë të pranishëm gjatë fazës së hapjes dhe të vlerësimit, por nuk kanë të drejtë të votojnë ose të ndikojnë në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japin mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe kryejnë funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi e ruajtja e dokumenteve.

3. Në procedurën e drejtpërdrejtë komisioni i vlerësimit të ofertave ndjek hapat, si më poshtë vijon:

a) lexon emrin dhe adresën e ofertuesit dhe hap zarfin përkatës;

b) lexon dhe verifikon listën e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesi ose personi i autorizuar i tij;

c) hap ofertën teknike dhe ofertën ekonomike;

ç) i komunikon përfaqësuesit ditën, vendin dhe orën për rezultatin e vlerësimit të ofertës dhe vijon punën për shqyrtimin e saj;

d) shqyrton dokumentacionin ligjor dhe kualifikues;

dh) vlerëson ofertën teknike dhe ekonomike;

e) kërkon sqarime nga ofertuesi, nëse e gjykon të nevojshme. Komunikimi kryhet drejtpërdrejt, me shkrim ose në rrugë elektronike dhe pasqyrohet në procesverbalin e prokurimit;

ë) nëse e gjykon të nevojshme, kryen për kontrata komplekse testimin e mallit ose shërbimit, por duke e njoftuar paraprakisht ofertuesin. Në rast se ofertuesi nuk pranon testimin, oferta e tij skualifikohet. Koha e testimit negociohet me ofertuesin dhe nuk mund të fillojë para dorëzimit të ofertës dhe duhet të përfundojë para shpalljes së fituesit;

f) merr vendim për ofertën e paraqitur dhe ia komunikon ofertuesit, jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga data e dorëzimit të ofertës;

g) shtyn kohën e vlerësimit të ofertës, në rast se afati i caktuar nuk është i mjaftueshëm për marrjen e një vendimi. Afati i ri i njoftohet ofertuesit.

4. Në procedurën “shtet me shtet”, nëpërmjet dhënies së autorizimit një vendi anëtar të NATO-s

ose agencie të NATO-s për të kryer procedurat e prokurimit, autoriteti kontraktor ndjek këta hapa:

a) kërkesën për prokurim;

b) negocion marrëveshjeve teknike ose kërkesën e veçantë për prokurim, ku duhet të përfshihen minimalisht:

i. palët;

ii. delegimi i autoritetit për të prokuruar në emër të Ministrisë së Brendshëm dhe/ose institucioneve në varësi;

iii. objekti i prokurimit;

iv. të dhënat teknike bashkë me vlerën e mallit ose shërbimit që kërkohet të prokurohet;

v. afati, vendi dhe mënyra e dorëzimit të mallit ose shërbimit;

c) nënshkruan marrëveshjen ose kërkesën e veçantë për prokurim;

ç) pret mallin ose shërbimin nga pala;

d) kryen pagesat përkatëse;

e) çdo veprim tjetër të nevojshëm.

5. Çdo hap i procedurës së prokurimit duhet të regjistrohet dhe të pasqyrohet në procesverbalin e prokurimit.

6. Njëri nga anëtarët e njësisë së prokurimit është gjithmonë përgjegjës për regjistrimin e çdo faze të procesit dhe tekstit përfundimtar të procesverbalit, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

7. Nëse anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave kanë mendime të ndryshme ose nëse komisioni vendos me votim, kjo gjë duhet të pasqyrohet në procesverbal, duke dhënë dhe argumentet përkatëse. Dokumentet që shoqërojnë ofertën, nuk u kthehen ofertuesve, por mbeten pjesë e dosjes së procedurës dhe administrohen prej tij.

8. Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të vlerësimit të ofertave, përgatit një raport përmbledhës dhe i propozon fituesin titullarit të autoritetit kontraktor.

9. Me përfundimin e afateve/procedurave të ankimit, autoriteti kontraktor njofton operatorin ekonomik të shpallur fitues dhe/ose njoftim anulimi.

Me përfundimin e afateve/procedurave të ankimit autoritetit kontraktor bën shpalljen e fituesit. Shpallja bëhet në Ministrinë e Brendshëm dhe i njoftohet me shkrim operatorit ekonomik të suksesshëm.



10. Autoriteti kontraktor, pas dërgimit të njoftimit të fituesit, fton operatorin ekonomik për negocimin e kontratës.

Neni 28

Negocimi i kontratës

1. Pas miratimit të fituesit, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron krijimin e komisionit të negocimit të kontratës për negocimin e kushteve të saj.

2. Ky komision ka në përbërje përfaqësues të strukturës përgjegjëse për hartimin e kontratave, specialistë të fushave të tjera, në varësi të specifikës së objektit të kontratës, si dhe në çdo rast përfaqësues të strukturës përfituese të mallit ose shërbimit.

3. Kontrata hartohet në gjuhën shqipe. Në rastin kur operatori i shpallur fitues është i huaj, kontrata hartohet edhe në gjuhën angleze.

4. Pas përfundimit të negocimit, titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij nënshkruan kontratën.

5. Komisioni i negocimit të kontratës mund të thërrasë anëtarët e grupit të punës për hartimin e projektit për saktësimin e elementeve teknike të kontratës. Personat e thirrur nga komisioni janë këshillues dhe jo vendimmarrës në përcaktimin e kushteve të kontratës.

6. Në çdo rast mbahet procesverbal i veçantë që nënshkruhet nga anëtarët e komisionit të negocimit të kontratës dhe personit të thirrur për këshillim.

7. Në çdo rast, komisioni nuk mund të negociojë detaje apo elemente konkrete të specifikimeve teknike, të cilat do të cenonin thelbin e tyre.

Neni 29

Anulimi i një procedure prokurimi

1. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:

a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit;

b) nëse nuk është paraqitur asnjë ofertë brenda afateve kohore;

c) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit;

ç) nëse të gjitha ofertat e paraqitura përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor.

2. Autoriteti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë, në bazë të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Autoriteti kontraktor njofton operatorët ekonomikë pjesëmarrës në prokurim, për anulimin e procedurës së prokurimit, së bashku me arsyet e anulimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit për anulim.

KREU VII

SHQYRTIMI I ANKESAVE

Neni 30

Procedura e shqyrtimit të ankesave

1. Çdo operator ekonomik, pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, që rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, mund ta kundërshtojë këtë vendim.

2. Ankesat, si për dokumentet e tenderit, ashtu edhe për vendimet e komisionit të vlerësimit të ofertave, duhet të dorëzohen pranë autoritetit kontraktor, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data kur ankimuesi është vënë në dijeni të dokumenteve ose vendimmarrjes që konteston.

3. Ankimuesi përdor formularin e ankesës, pjesë e dokumenteve të tenderit, që përmban emrin dhe adresën e ankimuesit, objektin e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëlqes së pretenduar.

4. Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave të pezullojnë vazhdimin e procedurës, derisa ankesa të shqyrtohet plotësisht.

5. Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, ku të paktën njëri është ekspert i fushës për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përgjatë kësaj, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm, i cili duhet të jetë ekspert fushë. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit lidhur me të.



6. Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankesën dhe për të ndihmuar komisionin/zyrtarin e ngarkuar për shqyrtimin e saj.

Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertës.

7. Vendimi për ankesën duhet të merret brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e saj.

8. Nëse kërkohet informacion tjetër nga ankimuesi, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri, pasi komisioni/zyrtari i ngarkuar me shqyrtimin e ankesës ta sigurojë këtë informacion.

9. Autoriteti kontraktor duhet të informojë ankimuesin për vendimin dhe arsyet për këtë vendim të marrë, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë pas marrjes së vendimit.

10. Autoriteti kontraktor, nëse nevojitet, duhet të zgjasë afatin kohor të procedurës së prokurimit aq sa zgjat periudha e pezullimit.

11. Në rastet kur afatet kohore të procedurës së prokurimit, për të cilat janë njoftuar ofertuesit, ndryshojnë për shkak të marrjes parasysh të ankesës, autoriteti kontraktor u shpërndan ofertuesve një njoftim të posaçëm, ku jepen arsyet për zgjatjen e këtyre afateve.

12. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin plotësisht ose pjesërisht të ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor.

13. Në rastin kur ankesa është pranuar, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës i dërgon vendimin për zbatim njësisë së prokurimit ose komisionit të vlerësimit të ofertave, duke njoftuar dhe titullarin e autoritetit kontraktor.

14. Vendimi i komisionit/zyrtarit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës është përfundimtar dhe, në çdo rast, i komunikohet me shkrim ankimuesit. Komunikimi i vendimit mund të bëhet edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej operatorit ekonomik në formularin e ankesës. Autoriteti kontraktor duhet të informojë ankimuesin për vendimin dhe arsyet për këtë vendim të marrë, jo më vonë se 24 (njëzet e katër) orë pas marrjes së vendimit.

15. Në rast se komisioni ka pranuar plotësisht apo pjesërisht ankesën, i vihet në dispozicion

njesisë së prokurimit, e cila brenda 2 (dy) ditëve pune harton shtojcën me ndryshimet përkatëse, si dhe njofton operatorin ekonomik. Në çdo rast të pranimit të ankesës, afati i dorëzimit të dokumenteve nga operatorët ekonomikë shtyhet me jo më pak se 3 (tri) ditë pune.

KREU VIII ZBATIMI I KONTRATËS

Neni 31 Nënkontraktimi

1. Autoriteti kontraktor mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës. Në asnjë rast, kontraktorët nuk mund të nënkontraktojnë mbi 40 (dyzet) % të kontratës në palë të treta.

2. Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nënkontraktimi. Në rastet kur mund të ketë nënkontraktor, autoriteti kontraktor të shprehet qartë që mund të lejohet pagesa e drejtpërdrejtë nënkontraktorit, por me garanci bankare ose sigurim të paraqitur nga ky i fundit.

3. Me dorëzimin e ofertave, ofertuesit duhet të deklarojnë pjesën e kontratës që ata kanë qëllim të nënkontraktojnë, në rast se shpallen fitues. Për kontratat që lidhen me çështje të informacionit, ekspozimi i të cilit është në kundërshtim me interesat e sigurisë kombëtare, autoriteti kontraktor duhet që të jetë shprehur më parë për kushtëzimet që ekzistojnë për nënkontraktorët.

4. Një kopje e noterizuar e kontratës së nënkontraktimit i dorëzohet autoritetit kontraktor, brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi saj, bashkë me dëshmitë e kualifikimeve dhe të kërkesave teknike të nënkontraktorit. Autoriteti kontraktor, pasi e shqyrton atë, ka të drejtë ta pranojë ose të refuzojë, brenda 10 (dhjetë) ditëve, duke dhënë arsyet përkatëse.

Neni 32 Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës

1. Gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor dhe organe të tjera shtetërore, të autorizuar me ligj, mund të mbikëqyrin veprimtarinë e kontraktorit apo të nënkontraktorit, vendin e zbatimit, afatet, si dhe cilësinë mallrave



apo të shërbimeve, në përputhje me kushtet e kontratës, si dhe legjislacionin në fuqi.

2. Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës realizohet nga struktura, përgjegjëse përfituese e punëve/mallrave/shërbimeve, e cila vlerëson realizimin e detyrimeve kontraktuale, sipas fazave të realizimit të kontratës dhe përgatit raportin përkatës për fazën në të cilën është zbatimi i kontratës.

3. Në përfundim të kontratës, struktura përgjegjëse, përfituese e punëve/mallrave/shërbimeve, përgatit një raport përmbledhës për titullarin e autoritetit kontraktor për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.

PJESA II

KOMISIONI I VEÇANTË I KLASIFIKIMIT

KREU IX

PËRBËRJA, MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE E FUNKSIONIMIT TË KVK-së

Neni 33

Organizimi dhe funksionimi i KVK-së

Komisioni i veçantë i klasifikimit (në vijim “KVK”) organizohet dhe funksionon si një strukturë e posaçme në Ministrinë e Brendshme, me qëllim klasifikimin e kontratave, si kontrata për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për fushën e sigurisë dhe/ose rendit publik, punë/mallra/shërbime, si dhe materialet për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe *software*-t e lidhura me këto mallra.

Neni 34

Detyrat e KVK-së

1. KVK-ja, në zbatim të përcaktimeve të nenit 33, të këtij vendimi, ka për detyrë:

a) të analizojë kërkesat për prokurim të hartuara nga strukturat e gjenerimit të tyre;

b) të klasifikojë natyrën e mallrave, punëve apo të shërbimeve të kërkuara nga strukturat gjeneruese, si mallra, punë ose shërbime, publikimi i informacioneve të të cilave do të dëmtonte interesat e ligjshëm shtetërorë ;

c) të vlerësojë dhe miratojë nga ana operacionale e funksionale kërkesat operacionale, të hartuara nga strukturat e gjenerimit të tyre.

2. Klasifikimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet 1 (një) herë për çdo tipologji pune, malli dhe shërbimi.

3. KVK-ja në përfundim paraqet një relacion ministrit për miratim të tij.

Neni 35

Përbërja e KVK-së

1. Komisioni i veçantë i klasifikimit do të përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, ndër të cilët 2 (dy) janë anëtarë të përhershëm, si më poshtë vijon:

a) drejtori i përgjithshëm, i cili mbulon çështjet ekonomike dhe të shërbimeve mbështetëse në Ministrinë e Brendshme, i cili kryen rolin e kryetarit (i përhershëm);

b) drejtori, i cili mbulon çështjet e kuadrit ligjor në Ministrinë e Brendshme (i përhershëm);

c) një përfaqësues nga struktura propozuese e projektit, sipas rastit.

2. Në mungesë të një prej anëtarëve të përhershëm, për shkaqe objektive, ministri i Brendshëm cakton me urdhër zëvendësuesin.

Neni 36

Mënyra e funksionimit të KVK-së

1. KVK-ja i zhvillon takimet sipas planit vjetor të punës, i cili hartohet dhe miratohet nga kryetari i tij, si dhe sa herë kërkohet nga kryetari ose autoriteti kontraktor.

2. Mbledhjet e KVK-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 2/3 e numrit të anëtarëve të tij. Ato bëhen të mbyllura dhe për to mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje dhe nga sekretari i KVK-së.

3. Rendi i ditës për mbledhjen e radhës së KVK-së hartohet nga sekretari i KVK-së dhe miratohet nga kryetari i këtij komisioni, i cili cakton afatin dhe vendin e mbledhjes. Sekretari njofton anëtarët e KVK-së dhe u vë në dispozicion dosjen përkatëse.

4. Materialet që do të analizohen në takim u shpërndahen anëtarëve të KVK-së nga sekretari i komisionit, jo më vonë se 2 (dy) ditë para ditës së takimit. Kur materialet që do të analizohen



kërkojnë më shumë kohë për t'u përpunuar, kryetari mund të shtyjë afatin e takimit të KVK-së.

5. Për çështje që do të analizohen dhe që mund të kenë nevojë për verifikime e informacione të mëtejshme, kryetari i KVK-së ka të drejtë të kërkojë ekspertë të fushës.

6. Relatimi dhe prezantimi i materialit në KVK bëhen nga titullari i strukturës gjeneruese.

7. Vendimet e KVK-së merren me shumicën e të gjitha votave të anëtarëve të KVK-së pjesëmarrës. Votimet në KVK bëhen të hapura.

8. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

9. Secili anëtar që voton kundër është i detyruar të shpjegojë kundërshtinë e tij, të cilat pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes. Nuk lejohet e drejta e abstenimit.

10. Vendimi duhet të jetë i argumentuar dhe i bazuar, duke përmendur në detaje referencat që kanë shërbyer si bazë për marrjen e këtij vendimi.

11. Vendimet e KVK-së, së bashku me procesverbalin e mbledhjes, i përcillen drejtpërdrejt ministrit të Brendshëm, i cili vendos kalimin ose jo për vijimin e procedurave të mëtejshme nga struktura përgjegjëse për prokurimin.

12. Kërkesat, që nuk klasifikohen, sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 5, të ligjit nr. 36/2020, i rikthehen strukturës që ka bërë kërkesën për prokurim.

13. Kryetari i komisionit të veçantë të klasifikimit u dërgon për rishikim strukturave gjeneruese kërkesat për prokurim të pamundura teknikisht. Komisioni i veçantë i klasifikimit vlerëson dhe miraton kërkesën e rishikuar.

14. Me kërkesë të institucioneve dhe/ose nga analiza e fakteve dhe rrethanave KVK-ja mund të vendosë caktimin për realizimin e procedurës së prokurimit një autoriteti tjetër.

Neni 37

Detyrat e kryetarit të KVK-së

1. Kryetari i KVK-së ushtron detyrat, si më poshtë vijon:

- a) drejton mbledhjet e KVK-së;
- b) siguron zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në marrjen e vendimeve;
- c) vendos për rendin e ditës për çdo takim, si dhe për datën e kohën e mbledhjes së radhës;
- ç) thërret mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të KVK-së, sipas nevojave;

d) voton i fundit për miratimin e çdo kërkesë apo projekti;

dh) nënshkruan vendimin dhe procesverbalin e mbledhjes;

e) paraqet drejtpërdrejt te ministri i Brendshëm të gjitha vendimet që merren nga KVK-ja dhe procesverbalet e mbledhjeve;

ë) raporton përpara ministrit, sipas kërkesave të këtij të fundit.

Neni 38

Detyrat e zëvendëskryetarit të KVK-së

Zëvendëskryetari i KVK-së zëvendëson kryetarin e KVK-së në ushtrimin e të gjitha kompetencave të tij, të përcaktuara në këtë vendim, në rastet e mungesave, të pamundësisë apo të paaftësisë fizike për të vepruar ose për shkak të një pengese ligjore që has gjatë veprimtarisë së tij.

Neni 39

Detyrat e anëtarëve të KVK-së

Anëtarët e KVK-së ushtrojnë detyrat, si më poshtë vijon:

1. Marrin pjesë në mbledhje dhe diskutojnë për çështjet që lidhen me miratimin e kërkesave për prokurim.

2. Marrin pjesë në votim.

3. Përgatiten për diskutim, propozojnë dhe japin mendime të argumentuara në lidhje me çështjet përkatëse.

4. Nënshkruajnë vendimin dhe procesverbalin e mbledhjes.

Neni 40

Detyrat e sekretarit të KVK-së

Sekretari i KVK-së caktohet nga kryetari dhe ushtron detyrat, si më poshtë vijon:

1. Administron e protokollon gjithë dokumentacionin e punës së KVK-së.

2. Cakton agjendën e punës dhe organizon takimet e KVK-së, pasi ka marrë miratimin nga kryetari.

3. Merr pjesë në mbledhjet e KVK-së, ku diskutohen çështje që lidhen me miratimin e kërkesave për prokurim dhe propozimeve teknike, pa të drejtë vote.



4. Mban procesverbalin e mbledhjeve të KVK-së.

5. Transkripton vendimin e marrë nga kryetari dhe anëtarët e KVK-së.

6. Merr nënshkrimin e të gjithë anëtarëve të KVK-së në vendimin dhe procesverbalin e mbledhjes.

7. Nënshkruan procesverbalin e mbledhjes, pas nënshkrimit nga të gjithë anëtarët e KVK-së.

KREU X DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 41

Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM Nr. 391, datë 29.6.2023

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 161, DATË 21.3.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PAGESËN E SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 54, pikat 1 e 2, dhe 55, pika 1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “c”, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) plotësojnë kriteret për pension pleqërie, invaliditeti të plotë apo pension familjar, paaftësi të përkohshme në punë apo sëmundje profesionale;”.

2. Shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” e “d”, të pikës 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) 3 (tre) muaj, për personat me një periudhë kontributi të derdhur si punëmarrës, të paktën, 1 (një) vit;

b) 6 (gjashtë) muaj, për personat me një periudhë kontributi të derdhur si punëmarrës, të paktën, 3 (tre) vjet;

c) 9 (nëntë) muaj, për personat me një periudhë kontributi të derdhur si punëmarrës, të paktën, 5 (pesë) vjet;

ç) 12 (dymbëdhjetë) muaj, për personat me një periudhë kontributi të derdhur si punëmarrës mbi 10 (dhjetë) vjet;

d) Personat gra dhe burra mbi 55 (pesëdhjetë e pesë) vjeç përfitojnë pagesë papunësie 12 (dymbëdhjetë) muaj, me kusht që të kenë kontribuar si punëmarrës 1 (një) vit në sigurimet shoqërore dhe të kenë mbushur moshën e sipërpërmendur para shkëputjes nga puna për herën e parë dhe në rast të paraqitjes së kërkesës për përfitimin e radhës i nënshtrohen rregullit të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të kësaj pike.”.

3. Në pikën 6 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Vërtetim për ndjekjen e arsimit të mesëm, për fëmijët në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, dhe vërtetim për personat që ndjekin arsimin e lartë apo janë vlerësuar me aftësi të kufizuar, sipas komisioneve përkatëse, deri në moshën 25 vjeç;”.

b) Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Nëse është rasti, vërtetim nga dega e tatimtaksave dhe sigurimeve shoqërore, të gjeneruar nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 1.1.1994 deri më 31.12.2011, sipas shkronjave “a” “b”, “c” e “ç”, të pikës 4;”.

4. Në pikën 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “b” shfuqizohet;

b) Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Vërtetim nga dega e tatimtaksave dhe sigurimeve shoqërore, të gjeneruar nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania* se personi ka derdhur kontribute si punëmarrës për periudhën 1.1.2012 e në vijim, përkatësisht sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 4.”.



5. Shkronja “ç”, e pikës 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) plotësojnë kriteret për pension pleqërie, invaliditeti të plotë apo pensioni familjar;”.

6. Pika 9 shfuqizohet.

7. Pika 14 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“14. Në rastet e punësimit të përkohshëm, gjatë periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, e ardhura e papunësisë merret me ndërprerje, si më poshtë vijon:

a) Brenda 6 (gjashtë) muajve nga rifillimi i periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, për personat që e përfitojnë pagesën për 3 (tre) muaj;

b) Brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga rifillimi i periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, për personat që e përfitojnë pagesën për 6 (gjashtë) muaj;

c) Brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve nga rifillimi i periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, për personat që e përfitojnë pagesën për 9 (nëntë) muaj;

ç) Brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga rifillimi i periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, për personat që e përfitojnë pagesën për 12 (dymbëdhjetë) muaj;

d) Në rastet e ndërprerjes të së ardhurës nga papunësia, për arsye të përfitimit të lejes së lindjes, pjesa e ngelur merret pas përfundimit të lejes së lindjes, për çdo rast përfitimi.”.

8. Shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 16, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“a) sëmundje e vërtetuar me dokumente fletështrimi (dorëzuar nga një përfaqësues i tij) dhe fletëdalje nga spitali (të dorëzuar nga një përfaqësues i tij ose vetë personi);

....

c) ndalimi nga organet e drejtësisë, e vërtetuar me dokumentacionin përkatës.”.

9. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Për të gjitha rastet e përmendura në pikën 16, pagesa e së ardhurës nga papunësia nuk do të regjistrohet në listëpagesën e muajit. Kjo e ardhur do të paguhet në momentin që personi paraqitet në zyrën e punësimit me një nga dokumentet justifikuese.”.

10. Pika 21 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“21. Punëkërkuksi i papunë, i cili qendren e fundit të punës e ka në juridiksionin e një zyre tjetër

punësimi nga vendbanimi aktual, përfitimin e merr në zyrën e punësimit ku ka vendbanimin aktual.”.

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 392, datë 29.6.2023

**PËR RISHPËRNDARJE FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2023,
MIRATUAR PËR NJËSITË E
QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2023, miratuar për njësitë e qeverisjes qendrore, bëhet rishpërndarja e fondit, si më poshtë vijon:

a) Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, në programin “*e-Qeverisja*”, në artikullin 231, i shtohet fondi prej 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, për projektin “Implementimi i laboratorëve *Smart*”;

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në programin “Forcat e luftimit”, në artikullin 231, i pakësohet fondi prej 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

**VENDIM****Nr. 393, datë 29.6.2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË
CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË
BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR
PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR
PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË
NË ARSIMIN E LARTË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 14 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në Bordin e Akreditimit merr pjesë edhe një student, në rolin e vëzhguesit, përfaqësues i Këshillit Kombëtar të Studentëve.”.

b) Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Mbledhja e Bordit të Akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 8 (tetë) anëtarë të tij. Vendimet e Bordit merren me shumicë prej $\frac{3}{4}$ të anëtarëve të pranishëm.”.

c) Pika 26 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“26. Kryetari dhe anëtarët e Bordit të Akreditimit paguhen për çdo pjesëmarrje në mbledhje. Për çdo vit kalendarik zhvillohen 12 (dymbëdhjetë) mbledhje. Nëse është e nevojshme, Bordi mund të mbledhet deri në 3 (tri) herë të tjera, brenda të njëjtit vit kalendarik, me kërkesë të ministrit përgjegjës për arsimin.”.

ç) Pika 27 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“27. Masa e shpërblimit për çdo mbledhje të jetë, si më poshtë vijon:

a) Anëtarët me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë, në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;

b) Anëtarët me rezidencë të përhershme jashtë Republikës së Shqipërisë, në masën 600 (gjashtëqind) euro;

c) Kryetari, në varësi të rezidencës së tij të përhershme, në masën 30% më shumë se anëtarët e Bordit.”.

d) Në paragrafin e parë, të pikës 2, të shtojcës 2, bashkëlidhur vendimit, pas fjalëve “... në IAL-të publike ...” shtohen “... dhe jopublike ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

VENDIM**Nr. 394, datë 29.6.2023**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË
MJEKIMIT TË ZNJ. EGLA LLESHAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe të vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2023”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Eglë Lleshaj, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Paga bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

**VENDIM****Nr. 395, datë 29.6.2023****PËR MUNDËSINË E OFRIMIT JASHTË
REGJIMIT TË PUNËS, TË
PËRCAKTUAR NGA PUNËDHËNËSI,
TË SHËRBIMEVE TË KONSULTAVE
AMBULATORE PËR PACIENTË JASHTË
SISTEMIT TË REFERIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 27, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë kriteret e ofrimit të shërbimeve të konsultave ambulatorë për pacientë jashtë sistemit të referimit.

2. Spitalet publike, të cilat do të mundësojnë ofrimin e praktikës së dyfishtë, sigurojnë:

a) akses të garantuar për qytetarët në marrjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, bazuar në rregullat e ofrimit të shërbimit, sistemin e referimit, cilësinë e shërbimit në çdo hallkë të ofrimit të shërbimit në spital;

b) transparencë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore nëpërmjet sistemit të referimit, pritjes së pacientëve dhe qytetarëve në recepsione apo struktura të konsultave ambulatorë, duke garantuar funksionalitetin e plotë të shërbimit spitalor;

c) sigurimin e shërbimeve spitalore nga konsultat ambulatorë tek shërbimi me shtretër në spital për të gjithë pacientët dhe qytetarët që kanë nevojë për kujdes shëndetësor;

ç) përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe normave të aktivitetit të shërbimit nga mjekët specialistë;

d) ofrimin e shërbimit spitalor publik për të gjithë pacientët, brenda dhe jashtë sistemit të referimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe rregullave për ofrimin e shërbimit shëndetësor në korsi të preferenciale.

3. Kriteret për ofrimin e praktikës së dyfishtë në spitalet publike janë, si më poshtë vijon:

a) Spitali të ketë përfituar kartën e autonomisë menaxheriale;

b) Spitali të garantojë përmbushjen e aktivitetit spitalor, bazuar në normativat e vendosura nga

bordi i spitalit dhe të përmbushë indikatorët e aktivitetit mjekësor, të përcaktuar në kontratën e financimit të spitalit;

c) Spitali të disponojë normat e aktivitetit klinik për çdo mjek specialist, sipas shërbimeve përkatëse, në regjimin që përcaktohet praktika e dyfishtë.

4. Mënyra e ofrimit të praktikës së dyfishtë në shërbimin e konsultave ambulatorë për pacientët jashtë sistemit të referimit realizohet, sipas procedurës së mëposhtme:

a) Mjeku specialist paraqet kërkesën në drejtorinë e spitalit publik për të ushtruar praktikën e dyfishtë, jashtë angazhimit kontraktual me punëmarrësin dhe kohës së punës, bazuar në këtë kontratë. Në kërkesën e tij përshkruhet orari i konsultave, të propozuara për pacientët jashtë sistemit të referimit, organizimi dhe mënyra e pritjes së pacientëve që do t’u ofrohet konsulta ambulatorë;

b) Drejtoria e spitalit vlerëson kërkesën e mjekut specialist, aktivitetin e mjekut në shërbim, përmbushjen e normave në shërbimin ku ushtron profesionin dhe modalitetet e propozuara të organizimit të konsultave ambulatorë, të propozuara në kërkesën e tij, brenda një afati 30 (tridhjetë)- ditor;

c) Pas vlerësimit, nëse kërkuuesi përmbush kërkesat, firmoset kontratë dypalëshe me spitalin publik për ofrimin e praktikës dyfishe. Kontrata e shërbimit është me afat të përcaktuar dhe ka të përcaktuar tarifat përkatëse të shërbimit dhe mënyrën e shpërndarjes së tyre, bazuar në tarifat preferenciale të vendosura nga bordi i spitalit;

ç) Numri i konsultave mujore për mjekët specialistë në sistemin e praktikës dyfishe përcaktohet në kontratën midis palëve dhe të ardhurat e mjekut nga praktika dyfishe nuk duhet të tejkalojnë 30 (tridhjetë) % të pagës bruto të tij.

5. Funksionimi i ofrimit të praktikës së dyfishtë në spitalet publike realizohet, si më poshtë vijon:

a) Spitali përcakton rregullat për kryerjen e praktikës së dyfishtë dhe vendos në dispozicion ambientet, sistemin e recepsionit dhe pritjes në strukturat e konsultave ambulatorë, si dhe logjistikën e nevojshme mjekësore dhe jomjekësore për të kryer konsultën ambulatorë;

b) Aktiviteti i praktikës së dyfishtë monitorohet nga grupi i posaçëm i monitorimit, i ngritur me vendim të bordit.



6. Spitali është përgjegjës për sistemin e mbledhjes së tarifës së konsultës ambulatorë, duke mundësuar, sipas një sistemi periodik mujor, shpërndarjen e të ardhurave të grumbulluara te mjeku specialist nga llogaria e spitalit.

7. Të ardhurat që gjenerohen nga spitali nëpërmjet praktikës së dyfishtë do të futen në zërin e të ardhurave dytësore dhe do të përdoren nga spitali për të përmirësuar më tej cilësinë e shërbimit të ofruar, bazuar në legjislacionin në fuqi.

8. Autoritetet drejtuese të strukturës spitalore publike afishojnë listën e stafit mjekësor të angazhuar në regjimin e praktikës së dyfishtë dhe tarifat përkatëse të shërbimit dhe i bëjnë ato transparente për publikun.

9. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe strukturat spitalore të sistemit shëndetësor publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 396, datë 29.6.2023

PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
KRYETARIT TË QENDRËS
KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Eduart Makri, kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM

Nr. 87, datë 21.6.2023

MBI DOKUMENTACIONIN DHE
PROCEDURËN PËR APLIKIMIN,
VLERËSIMIN, MIRATIMIN DHE
REFUZIMIN E KËRKESËS PËR
SHPALLJEN E STATUSIT TË
PASHTETËSISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 54, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”,

UDHËZOJ:

1. Personat e huaj që gjenden pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë mund të paraqesin kërkesë pranë autoritetit përgjegjës për azilin, të huajt dhe shtetësinë, në ministrinë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, për shpallje të statusit të pashtetësisë.

2. Kërkesa për shpalljen e statusit të pashtetësisë paraqitet personalisht nga i huaji ose nga përfaqësuesi i autorizuar, shoqëruar me formularin e aplikimit të përcaktuar në aneksin nr. 1, të këtij udhëzimi, duke bashkëngjitur dokumentacionin si vijon:

a) certifikatë lindjeje apo ndonjë dokument tjetër ekuivalent;

b) dëshmi e lëshuar nga spitali pas lindjes;

c) certifikatë martese;

d) dokument identifikimi ose udhëtimi të prindërve, bashkëshortit/es ose fëmijëve;

dh) dokument udhëtimi (përfshi edhe ato që i ka mbaruar afati);

e) dokument që vërteton vendbanimin në Republikën e Shqipërisë;

ë) dokument që vërteton vendbanimin e fundit/mëparshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

f) dokument apo dëshmi të lëshuar nga autoriteti i huaj që vërteton se personi nuk është shtetas i shtetit përkatës;

g) dëshmi që nuk është nën ndjekje dhe i dënuar për vepra penale, lëshuar nga prokuroria e rrethit gjyqësor dhe gjykata e rrethit gjyqësor, ku ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë.

3. Në rastet kur kërkuuesi është fëmijë apo person me aftësi të kufizuara, kërkesa bëhet nga prindi ose përfaqësuesi ligjor i autorizuar.



4. Sektori përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë, lëshon një vërtetim për pranimin e kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë.

5. Në rastet kur gjatë shqyrtimit të kërkesës për shpalljen e statusit të pashtetësisë konstatohet se nga kërkuesi ekziston edhe një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare/mbrojtje plotësuese/mbrojtje shtesë, me aprovimin e kërkuesit, do të ndërpritet procedura për këtë status dhe personi do të konsiderohet si azilkërkues dhe do të trajtohet sipas dispozitave të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

6. Brenda 30 ditëve nga depozitimi i kërkesës dhe dokumentacionit të përcaktuar në këtë udhëzim, kërkuesi do t'i nënshtrohet intervistës, e cila do të kryhet në gjuhën që ai/ajo kupton me prezencën e përkthyesit.

7. Pas dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit të nevojshëm autoriteti përgjegjës, i caktuar pranë Drejtorisë së Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë, njofton kërkuesin për ditën dhe orën e intervistës, të paktën pesë (5) ditë para zhvillimit të saj.

8. Para intervistës sektori përgjegjës bën një vlerësim të plotë të dosjes, duke përfshirë:

a) shqyrtimin e kërkesës dhe formularit të aplikimit;

b) shqyrtimin e dokumentacionit shoqërues të kërkesës;

c) identifikimin e dokumentacionit të munguar apo të paqartë, për të cilin mund të kërkohej informacion/plotësim ose shpjegim gjatë intervistës.

9. Intervista do të zhvillohet në kushte konfidenciale dhe në të mund të jenë prezentë:

a) përfaqësuesi ligjor i autorizuar;

b) përfaqësuesi i UNHCR-së.

10. Në intervistën me fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara duhet të jenë prezent:

a) kujdestari ligjor për fëmijët e pashoqëruar;

b) kujdestari për persona me aftësi të kufizuara;

c) përkthyesi.

11. Gjatë zhvillimit të intervistës do të mblidhen të dhënat lidhur me çështjet, si në vijim;

a) identiteti i saktë i kërkuesit për statusin e pashtetësisë dhe i anëtarëve të tjerë të familjes;

b) mënyrën e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë;

c) faktin nëse kanë paraqitur kërkesën për

shtetësi apo për njohjen e statusit të personit pa shtetësi në ndonjë shtet tjetër;

d) lidhja me ndonjë shtet tjetër si: vendi i lindjes, prejardhjes së prindërve, vendbanimit, martesës apo lindjes së fëmijëve të tyre.

12. Intervista do të dokumentohet në një procesverbal, i cili do t'i komunikohet në gjuhën që ai/ajo kupton dhe do të nënshkruhet nga kërkuesi, sektori përgjegjës, si dhe pjesëmarrësit e tjerë në intervistë.

13. Gjatë zhvillimit të procedurës mblidhet informacion nga vendi i origjinës për situatën politike, ekonomike, sociale, situatën e të drejtave të njeriut.

14. Sektori përgjegjës i referohet shteteve me të cilat kërkuesi ka lidhje të mundshme të shtetësisë, si:

a) shtetit të lindjes;

b) shtetit në të cilin personi ka pasur vendbanimin e fundit;

c) shtetit apo shteteve të shtetësisë së prindërve/bashkëshortëve.

15. Pas zhvillimit të intervistës punonjësi, sektori përgjegjës nis procesin e verifikimit dhe nëse është e nevojshme merr informacione edhe përmes institucioneve relevante të përfaqësive të huaja diplomatike dhe organizatave ndërkombëtare.

16. Sektori përgjegjës shqyrton dhe analizon dëshminë e dhënë gjatë intervistës, si dhe të gjithë dokumentacionin e depozituar, për të vërtetuar saktësinë e dëshmisë së dhënë dhe provave të ofruara gjatë procedurës.

17. Pas vlerësimit të të gjithë aplikimit, sektori përgjegjës harton vendimin së bashku me rekomandimin e nënshkruar prej tyre, për shpalljen ose refuzimin e statusit të pashtetësisë, sipas aneksit nr. 2 të këtij udhëzimi, dhe e përcjell për miratim pranë drejtorit të Drejtorisë së Azilit, të Huajve dhe Shtetësisë. Pasi rekomandimi shqyrtohet nga drejtori i Drejtorisë i përcillet drejtorit të përgjithshëm të Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin për miratim, brenda periudhës kohore prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh nga data e aplikimit.

18. Drejtori i Drejtorisë së Azilit, të Huajve dhe Shtetësisë, si dhe drejtori i përgjithshëm për Zhvillimin e Migracionit dhe Azilit, kanë të drejtë të japin rekomandime shtesë dhe ta kthejnë dosjen për rishqyrtim në rast të mosdakordësisë me



rekomandimet e përcjella nga sektori përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës për statusin e pashtetësisë.

19. Afati i përcaktuar në pikën 17, mund të zgjatet për një periudhë shtesë prej 3 (tre) muaj, në rastet kur:

a) kemi të bëjmë me çështje komplekse, faktike ose ligjore;

b) një numër i madh i shtetasve të huaj kanë paraqitur njëherësh kërkesë për përcaktimin e statusit të pashtetësisë, duke e bërë të vështirë në praktikë përfundimin e procedurës brenda afatit 6 (gjashtë)-muajor.

Në këto raste, sektori përgjegjës informon kërkuesin për arsyet e shtyrjes dhe afatet kohore brenda të cilave pritet të merret vendimi për kërkesën e tij.

20. Brenda pesë (5) ditësh pune që nga data e marrjes së vendimit, kërkuesi ose përfaqësuesi i autorizuar njoftohet me shkrim.

21. Kundër vendimit të refuzimit të shpalljes së statusit të pashtetësisë, kërkuesi ka të drejtën të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

22. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Zhvillimit për Migracionin dhe Azilin dhe Drejtorja e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë.

23. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

ANEKS NR. 1
ANEX NO. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRY OF INTERIOR

FORMULAR APLIKIMI PËR SHPALLJEN E STATUSIT TË PERSONIT PA SHTETËSI
APPLICATION FORM FOR THE DECLARATION OF STATELESS PERSON STATUS

1. Informacion mbi aplikantin <i>1. Information on the applicant</i>			
1.1 Të dhëna personale <i>1.1 Personal information</i>			
Mbiemri <i>Surmane</i>		Emrat <i>Names</i>	
Emri i nënës <i>Mother's name</i>		Emri i babait <i>Father's name</i>	
Datëlindja <i>Birthdate</i> (dd.mm.yyyy)		Shteti i lindjes <i>Country of birth</i>	
Vendi i lindjes/ <i>Birth place</i>		Shtetësia(të) e mëparshme <i>Former citizenship/s</i>	
Gjinia/Gender ☐ Mashkull/Male ☐ Femër/Female ☐ E panjohur/Other			
Gjendja Civile/Civil Status ☐ Martuar/Married ☐ Beqar/Single ☐ Divorcuar/Divorced ☐ I(e) Ve /Widowed ☐ Partner Civil/ Civil Partner			
Profesioni dhe/ose trajnimi: <i>Profession and/or training:</i>		Gjuha mëmë: <i>Mother tongue</i>	
1.2 Informacioni i kontaktit <i>1.2 Contact information</i>			



Adresa <i>Address</i>		
Rruga: Nr. <i>Street: No.</i>		
Fshati/Qyteti Shteti <i>Village/City- Country</i>		
Tel./cel./fax <i>Phone/Telephone/ Fax</i>		
Email		
2. Informacion mbi anëtarët e familjes <i>2. Information on family members</i>		
2.1 Bashkëshorti ose partneri civil <i>2.1 Spouse or Civil partner</i> ☐ I pamartuar/ <i>Unmarried</i>		
Mbiemri <i>Surname</i>	Emrat <i>Names</i>	
Datëlindja <i>Birthdate</i> (dd.mm.yyyy)		
Shtetësia(të) aktuale <i>Current citizenship/s</i>		
Adresa (rruga, nr., qyteti/fshati) <i>Address (street, no, city, village)</i>		
2.2 Fëmijë të mitur në kujdestari <i>2.2 Minor children under your custodianship</i> ☐ Nuk kam fëmijë në kujdestari <i>I don't have children under my custodianship</i>		
Ju lutemi deklaroni të gjithë fëmijët në kujdestari <i>Please declare all the children under your custodianship</i>		
Emri/ <i>Name</i>	Mbiemri/ <i>Surname</i>	Datëlindja/ <i>Birthdate</i> (ddmmyyyy)
Nëse keni më shumë se pesë fëmijë, fusni informacionin e fëmijëve të mbetur në një aneks të veçantë <i>If you have more than five children, enter the remaining children's information in a separate annex</i>		
3. Kushtet e hyrjes në Republikën e Shqipërisë <i>3. Conditions of entry in the Republic of Albania</i>		
Kur dhe në cilin PKK keni hyrë në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? <i>When and at which Border Crossing Point (BCP) did you enter Albania (dd.mm.yyyy)?</i>		
Datë/ <i>Date</i> : PKK/ <i>BCP</i> :		
Mënyra e hyrjes/ <i>Method of entry</i> : Me vizë/ <i>With a visa</i> _____ Specifiko llojin e vizës/ <i>Specify type of visa</i> _____		



Dokumentet e udhëtimit me të cilat keni hyrë në territorin e Shqipërisë/ The travel documents with which you entered the territory of Albania: _____ (Pasaportë/ *Passport, Laisser-passer*,...)

Autoriteti që ka lëshuar dokumentin/ *Authority that issued the document*:

Vendi i lëshimit/ *Issuing place*: _____ Nr./ *Nº*: _____

Data e lëshimit/ *Issuing date*: _____ Data e skadimit/ *Expiration date*: _____

4. Vendbanimet e mëparshme jashtë vendit
4. Previous residences abroad

SHTETI <i>COUNTRY</i>	QYTETET <i>CITIES</i>	NËN ÇFARË STATUSI <i>UNDER WHAT STATUS</i>	DATAT <i>DATES</i>	ADRESA <i>ADDRESS</i>

A keni kërkuar mbrojtje nga ndonjë ambasadë/konsullatë në Shqipëri apo jashtë?
Have you sought protection from any Embassy/Consulate in Albania or abroad?

Po Jo
Yes No

Nëse po, specifiko cilën ambasadë/konsullatë, si dhe datën, arsyet dhe rezultatet e kësaj përpjekjeje:
If yes, specify which Embassy/Consulate, as well as the date, reasons and results of this attempt:

A keni kërkuar azil/mbrojtje ndërkombëtare/mbrojtje plotësuese në Shqipëri?
Have you applied for asylum/international protection/subsidiary protection in Albania?

Po Jo
Yes No

Nëse po, shënoni numrin tuaj të rastit/ *If yes, enter your case number*: _____

Statusi i aplikimit/ *application status*: _____

5. Arsyet për kërkesën tuaj
5. Reasons for your request

Për çfarë arsye jeni duke aplikuar për status të personit të pashtetësi?
For what reason are you applying for stateless person status?

Shkruaj një pasqyrë të saktë dhe të personalizuar të rrethanave në të cilat juve ju është mohuar shtetësia. Ju duhet të specifikoni çfarë masash keni ndërmarrë për të fituar shtetësinë, duke bashkëngjitur të gjitha dokumentet e ndërlidhura me procedurë. Dokumentet e lëshuara nga autoritetet e huaja dhe që deklarojnë se ju nuk keni shtetësi të asnjë nga vendet me të cilat mund të jetë e lidhur situata juaj, duhet t'i bashkëngjiten dosjes.

Write an accurate and personalized account of the circumstances in which you were denied citizenship. You must specify what measures you have taken to obtain citizenship by attaching all documents related to the procedure. Documents issued by foreign authorities stating that you do not have the citizenship of any of the countries to which your situation may be related must be attached to the file.



6. Deklarime përfundimtare

6. Final statements

Foto

Photo

Unë po aplikoj për statusin e pashtetësisë në Shqipëri dhe nëpërmjet kësaj, konfirmoj me nënshkrimin tim që informacioni i paraqitur në këtë aplikim dhe shtojcat e tij janë korrekte dhe të sakta.

I am applying for stateless status in Albania and hereby confirm with my signature that the information presented in this application and its attachments are accurate and correct.

Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacion të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një vepër e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri.

I am aware that submitting false documentation and personal written information to the authorities is a punishable offense under the Criminal Code of Albania.

Vendi dhe data

Place and date

Nënshkrimi

Signature

Emri në shkronja kapitale

Name in capital letters

Nënshkrimi i fëmijës nëse është mbi 18 vjeç: _____

Signature of the child if he/she is over 18 years old

Emri në shkronja kapitale

Name in capital letters

7. Shtojca të detyrueshme

7. Mandatory attachments

PO

YES

JO

NO

Dokumentet që i duhen bashkëngjitur kërkesës për njohjen e statusit të personit pashtetësi

Documents that must be attached to the request for the recognition of the stateless person's status

Certifikata e lindjes apo ndonjë dokument tjetër ekuivalent

Birth certificate or any other equivalent document

Dëshmi e lëshuar nga spitali pas lindjes

Certificate issued by the hospital after birth

Dokument identifikimi- letërnjoftim, pasaportë apo dokument i udhëtimit për të huaj

(përfshirë edhe ato me afat të skaduar)

Identification document - identity card, passport or travel document for foreigners

(including expired ones)

Certifikata e martesës

Marriage certificate

Dokument identifikimi ose udhëtimi të prindërve, bashkëshortit ose fëmijëve

Identification or travel document of parents, spouse or children



Dokumentet e imigrimit apo lejet e vendbanimit të shtetit të mëhershëm të vendbanimit <i>Immigration documents or residence permit of the former state of residence</i>		
Një dokument apo dëshmi e lëshuar nga autoriteti i huaj që vërteton se personi nuk është shtetas i i shtetit përkatës <i>A document or certificate issued by a foreign authority certifying that the person is not a citizen of the relevant country</i>		
Vërtetim që nuk është nën hetim penal dhe që nuk është i dënuar për vepra penale, e lëshuar nga prokuroria e rrethit gjyqësor dhe nga gjykata e rrethit gjyqësor ku ka vendbanimin në Republikën e Shqipërisë <i>Certificate that she/he is not under criminal investigation and that she/he has not been convicted of criminal offenses, issued by the Prosecutor's Office of the Judicial District and by the Court of the Judicial District where he resides in the Republic of Albania</i>		
2 fotografi identike jo më të vjetra se 6 muaj <i>2 Identical photographs taken within the last 6 months</i>		
Dokumente të tjera relevante bashkangjitur me këtë kërkesë: <i>Other relevant documents attached to this request:</i>		
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		

Kërkesa e pranuar në datë _____

Request accepted on date

Nënshkrimi i punonjësit përgjegjës në Ministrinë e Brendshme _____

The signature of the responsible employee at the Ministry of the Interior

SHËNIM. Të dhënat e depozituara në këtë kërkesë do të trajtohen në bazë të legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave dhe parimit të konfidencialiteti.

NOTE: The data submitted in this application will be treated in accordance with national data protection legislation and the principle of confidentiality.

ANEKS NR. 2

ANEX NO.2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR

MIGRACIONIN DHE AZILIN

DREJTORIA E POLITIKAVE PËR AZILIN, TË HUAJT DHE SHTETËSINË

MINISTRY OF INTERIOR

GENERAL DIRECTORATE OF DEVELOPMENT FOR MIGRATION AND ASYLUM

DIRECTORATE OF ASYLUM, FOREIGNERS AND CITIZENSHIP POLICY

VENDIM

VERDICT



Sot më datë dd.mm.yy, Drejtoria e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë, në Ministrinë e Brendshme, mori në shqyrtim kërkesën për shpalljen e statusit të pashtetësisë në Republikën e Shqipërisë, të kërkuarit **emër mbiemër**. Drejtoria, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe dëshminë e dhënë gjatë intervistës, konstatoi:

*Today, on DD.MM.YY, the Directorate of Asylum, Foreigners and Citizenship Policies, in the Ministry of the Interior, considered the request for the declaration of statelessness status in the Republic of Albania, of the applicant's **name and surname**. The Directorate, after reviewing the documentation and the testimony given during the interview, concluded:*

I. Subjekti:

I. Subject

Z./Znj. EMËR MBIEMËR

Mr/Ms NAME SURNAME

Emri/ Name:

Mbiemri/ Surname:

Atësia/ Father's namer:

Seksi/ Sex:

Vendlindja/ Birthplace:

Datëlindja/ Birthdate:

Arsimi/ Education:

Gj. Civile/ Civil Status:

Kombësia/ Nationality:

Shtetësia/ Citizenship:

II. Baza ligjore: Neni 40 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 79/2021, “Për të huajt”, Konventa për statusin e personave pashtetësi, dhe Konventa për reduktimin e pashtetësisë.

II. Legal Basis: Article 40 of the Constitution of the Republic of Albania; Law no. 79/2021 “For foreigners”, Convention on the status of stateless persons, and Convention on the reduction of statelessness.

III. Përmbledhje e hapave procedural:

III. Summary of procedural steps:

1. Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë (data dhe vendi i hyrjes)

Entry into the territory of the Republic of Albania (date and place of entry)

2. Data e vetëdeklarimit të pashtetësisë së tij/saj (sigurohet nga Formulari i Përzgjedhjes së Shtetasve të Huaj të Parregullt).

Date of self-declaration of his/her statelessness (provided by the Irregular Foreign Nationals Selection Form).

3. Shqyrtimi i kërkesës për përcaktimin e statusit të pashtetësisë

(shënohet data e shqyrtimit të kërkesës);

Examination of the request for determining the Status of Statelessness (the date of consideration of the request is noted);

Kërkuari ka parashtruar faktet lidhur me kërkesën e tij bazuar në parashikimet e këtij udhëzimi në gjuhën _____ (shënohet gjuha që flet kërkuari në prani të një përkthyesi zyrtar).

The applicant has submitted the facts related to his request based on the provisions of this instruction in _____ language (the language spoken by the applicant in the presence of an official translator is noted).

IV. Deklarimi i fakteve

IV. Statement of facts

**Faktet e çështjes*****The facts of the case***

Këtu të jepet një përmbledhje e fakteve të parashtruara nga kërkuesi _____, si dhe provave të mbledhura gjatë verifikimit nga drejtoria përgjegjëse.

Here is a summary of the facts presented by the applicant _____, as well as the evidence collected during the verification by the Responsible Directorate.

V. Arsyetimi**V. Justification**

Në këtë pjesë jepet arsyetimi i bërë nga kërkuesi nëse plotëson kriteret e parashikuara në udhëzim.

In this part, the justification given by the applicant if it meets the criteria provided in the instruction is given.

Sipas pasrashikimeve të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, pika 30, e nenit 3, të këtij ligji jep përkufizimin e termit “Person pa shtetësi”, ku citohet se:

According to the provisions of the law no. 79/2021 “For foreigners”, point 30 of article 3 of this law defines the term “Stateless person”, where it is quoted that:

“Person pa shtetësi” është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

“Stateless person” is a person who does not have the citizenship of any country”.

Nga shqyrtimi i çështjes në tërësi (dokumentacion dhe intervistë) Drejtoria e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë vlerëson nëse kërkuesi i plotëson të gjithë kriteret dhe dokumentacionin e parashikuar nga ky udhëzim për shpalljen e statusit të pashtetësisë në Republikën e Shqipërisë.

From the consideration of the case as a whole (documentation and interview), the Directorate of Asylum, Foreigners and Citizenship Policies assesses whether the applicant meets all the criteria and documentation provided by this instruction for the declaration of statelessness status in the Republic of Albania.

Në rastet kur kërkuesi nuk plotëson kushtet e parashikuara nga ky udhëzim, por plotëson kushtet për njohjen e statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, atëherë me aprovimin e tij/saj do të vijohet me procedurat për njohjen e këtij statusi dhe do të anulohet procedura për shpalljen e statusit të pashtetësisë.

In cases where the applicant does not meet the conditions provided by this instruction, but meets the conditions for recognition of refugee status or subsidiary protection, according to the provisions of law no. 10/2021 “On Asylum in the Republic of Albania”, then with his/her approval the procedures for the recognition of this status will be continued and the procedure for the declaration of statelessness will be cancelled.

Për sa më sipër, Drejtoria e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë vlerëson se janë shfaqur arsye thelbësore për të besuar se ky shtetas i përmbush kriteret për t’ju shpallur statusi i personit pashtetësi (sipas rastit).

As per the above, the Directorate of Policies for Asylum, Foreigners and Citizenship, estimates that substantial reasons have appeared to believe that this citizen fulfills the criteria to declare the Stateless Person Status (according to the individual case).

**PËR KËTO ARSYE,
FOR THESE REASONS,**

bazuar në nenin 54, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, dhe udhëzimit _____.2023, Drejtoria e Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë,

Based on Article 54 of Law no. 79/2021 “For foreigners”, and the instruction _____.2023, Directorate of Policies for Asylum, Foreigners and Citizenship,

**VENDOSI:**
DECIDED:

Shpalljen e statusit të personit pashtetësi në Republikën e Shqipërisë, për z./znj. **Emër Mbiemër**.
*Declaration of Stateless Person Status in the Republic of Albania, for Mr./Mrs. **Name Surname**.*

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I ZHVILLIMIT PËR MIGRACIONIN DHE AZILIN
General Director of Migration and Asylum Development

Miratoi: Drejtori i Politikave për Azilin, të Huajt dhe Shtetësinë _____.
Approved by: Director of Asylum, Foreigners and Citizenship Policies

Përgatiti: Punonjësi përgjegjës _____.
Prepared by: Responsible employee

URDHËR
Nr. 72, datë 16.6.2023

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “KARAVASTA SOLAR” SHPK
PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM TË PASURISË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I LINJËS 220 kV
TË IMPIANTIT FOTOVOLTAIK
KARAVASTA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 28, të pikës 2, të nenit 31 dhe nenit 32 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 1.2.2023, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 220 kV të Impiantit Fotovoltaik Karavasta””,

URDHËROJ:

1. Miratimin e marrjes në përdorim të përkohshëm nga shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. të pasurive private që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 220 kV të Impiantit Fotovoltaik Karavasta”, sipas tabelës bashkëlidhur. Marrja në përdorim të përkohshëm e pasurive private nuk mund të zgjasë pas rënies së shkakut të ligjshëm dhe, në çdo rast, jo më shumë se 2 vjet nga data e këtij urdhri.

2. Shoqëria “Karavasta Solar” sh.p.k. të paguajë shpërblimin e ofruar dhe/ose kërkuar nga pronarët e pasurisë/pasurive të paluajtshme, për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë private. Në çdo rast vlera për përdorim të përkohshëm të pasurisë/pasurive private të paluajtshme, duhet të jetë jo më pak se tarifat shtetërore.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 35, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, ky urdhër përbën titull ekzekutiv.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**



Lista e parcelave të tokës për marrje në përdorim të përkohshëm (për një periudhë 6 mujore)															
Nr. Shtyllë	Nr. Fshati	Nr. Kadastral	Nr. Pasurite	Kategoria	Pronari	Kartelë Fragment pasurite i Hartës	Sipërfaqja e prekur (m2)	Rruga Sip. Totale aksesit (m2)	Kompensimi të mbjellave						
									Arsyerja	Periudha (ditë nga momenti i aprovimit)	Vlera e qirash së tokës (Lek)	Uoqi të mbjellës	Vlera e kompensimit të të mbjellave (Lek)		
1	19	Seman	3300 33/39	Token bujqësore	Sokrat Pend Kolici	Po	800	0	800	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	63012.0	Grure	0	63012.0
2	31	Dermentas	1471 15/4	Token bujqësore	Ismet Bacinozi	Po	600	0	600	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	47259.0	Jonxhë	12516	59775.0
3	31	Dermentas	1471 15/27	Token bujqësore	Adem Haki Kabashi	Po	400	0	400	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	31506.0	Jonxhë	8344	39850.0
4	32	Çlirim	1414 2/48	Token bujqësore	Irena Hasan Elezi	Jo	200	0	200	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	15753.0	Elb	2026	17779.0
5	33	Çlirim	1414 48/12	Token bujqësore	Marinela Dino Cani	Po	400	0	400	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	31506.0	Jonxhë	8344	39850.0
6	33	Çlirim	1414 48/13	Token bujqësore	Xhuljeta Dino Marinis Rezart Jorgji Komini, Jorgji Andon Komini, Klarita Jorgji Damo, Defrim Selim Adani, Hatie Fasli Kollundra, Lumturi Selim Muca, Shkelqim Selim Kollundra, Ditur Selim Xhelo	Po	210	0	210	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	16540.7	Jonxhë	2912.7	19453.4
7	33	Çlirim	1414 48/14	Token bujqësore		Jo	290	0	290	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	22841.9	Elb	2937.7	25779.6
8	38	Çlirim	1414 53/14	Token bujqësore		Jo	400	0	400	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	31506.0	Grurë	5548	37054.0
9	38	Çlirim	1414 56/32	Token bujqësore	Ibrahim Astrit Shehu	Po	400	0	400	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	31506.0	Elb	4052	35558.0
10	42	Vadize	3691 127/3	Token bujqësore	Tasi Kito Bistika	Jo	200	0	200	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	15753.0	Grure	2774	18527.0
11	45	Vadize	3691 149	Token bujqësore	Ervin Hodo Memo	Jo	800	0	800	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	63012.0	Dierre	0	63012.0
12	45	Vadize	3691 149/16	Token bujqësore	Ervin Hodo Memo	Jo	800	0	800	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	63012.0	Dierre	0	63012.0
13	45	Vadize	3691 149/17	Token bujqësore	Ervin Hodo Memo	Jo	800	0	800	Ndërtimi i Linjës së Transmetimit të Tensionit të Lartë	180	63012.0	Dierre	0	63012.0



Lista e parcelave të tokës për marrje në përdorim të përkohshëm (për një periudhë 6 mujore)															
Nr.	Nr. Shyllë	Fshati	Nr. Kadastral	Nr. Pasurie	Kategoria	Pronari	Kartelë Fragment pasurie i Hartës	Sipërfaqja e prekur (m2)	Rruga Sip. Totale aksesit (m2)	Kompensimi të mbjellave					
										Arsyeja	Periudha (ditë nga momenti i aprovimit)	Vlera e qirave të tokës (Lek)	Uloji i të mbjellës	Vlera e kompensimit të të mbjellave (Lek)	
14	49	Zhupan	3691	292/52	Token bujqësore	Leonard Fatmir Braka	Jo	400	0	400	180	31506.0	Dierre	0	31506.0
15	49	Zhupan	3934	280/320	Token bujqësore	Drini Braka	Po	465	365	830	180	65375.0	Dierre	0	65375.0
16	49	Zhupan	3934	280/559	Token bujqësore	Majlinda Feti Sinaj	Jo	335	0	335	180	26386.3	Dierre	0	26386.3
17	49	Zhupan	3934	280/560	Token bujqësore	Majlinda Feti Sinaj	Jo	335	0	335	180	26386.3	Dierre	0	26386.3
18	50	Zhupan	3934	3/30	Token bujqësore	Lutijë Haxhi Lilo, Marijeta Bajram Lilo, Denis Bajram Lilo, Blerta Barjam Buzi, Arta Barjam Allaj, Laura Barjam Braho	Po	800	25	825	180	64981.1	Dierre	0	64981.1
19	52	Peshthan i Vogël	2939	22/9	Token bujqësore	Myrte Zenel Fejzulla	Jo	480	500	980	180	77189.7	Dierre	0	77189.7
20	52	Peshthan i Vogël	2940	22/10	Token bujqësore	Myrte Zenel Fejzulla	Jo	480	0	480	180	37807.2	Dierre	0	37807.2
21	53	Drizë	1557	317/270	Token bujqësore	Buletin Jashar Gorreja	Jo	800	305	1105	180	87035.3	Dierre	0	87035.3
22	53	Drizë	1558	317/271	Token bujqësore	Buletin Jashar Gorreja	Jo	400	305	705	180	55529.3	Dierre	0	55529.3
23	54	Drizë	1557	317/80	Token bujqësore	Nasi Jorgji Budo	Jo	800	160	960	180	75614.4	Grure	13315.2	88929.6
24	56	Drizë	1557	256/19	Token bujqësore	Alket Abedin Lilo	Po	500	130	630	180	49622.0	Grure	8738.1	58360.1



Lista e Koordinatave ne KRRGISH e zonave parcelore të cilat do të merren në përdorim të përkohshëm														
Shtylla	Pika kendore 1	Pika kendore 2	Pika kendore 3	Pika kendore 4	Pika kendore 5	Pika kendore 6	Pika kendore 7	Pika kendore 8	Pika kendore 9	Pika kendore 10	Pika kendore 11	Pika kendore 12	Pika kendore 13	Pika kendore 14
19	N 456243 0783	456261 4926	456283 1905	456265 3652										
	E 4516276 688	4516256 592	4516275 745	4516296 818										
	E 458397 6201	458426 263	458435 7736	458407 2362										
31	N 4512242 455	4512232 388	4512257 164	4512267 622										
	E 458550 905	458576 5199	458563 9761	458588 482										
32	N 4512058 938	4512047 746	4512086 394	4512075 961										
	E 458824 3929	458834 9217	458805 7243	458795 4048										
33	N 4511900 186	4511924 263	4511936 454	4511911 569										
	E 459492 7691	459497 5204	459494 9255	459499 758	459490 8161	459501 9104	459528 1817	459517 2287						
38	N 4511104 616	4511101 989	4511110 252	4511108 407	4511111 856	4511138 1	4511127 246	4511100 884						
	E 459898 8742	459922 9417	459934 8688	459910 2293										
42	N 4509647 133	4509637 434	4509666 978	4509677 721										
	E 460171 6399	460196 706	460202 9458	460178 0638										
45	N 4508639 992	4508648 01	4508617 442	4508608 186										
	E 460595 3278	460599 4409	460613 8194	460615 6804	460619 473	460624 2038	460622 2855	460627 3824	460618 9184	460620 2685	460616 1623	460588 7817	460596 2924	460623 5352
49	N 4507511 612	4507514 96	4507511 072	4507516 305	4507502 994	4507504 809	4507488 792	4507487 44	4507478 781	4507473 535	4507489 793	4507481 929	4507454 996	4507462 488
	E 460634 9273	460645 9275	460674 6878	460663 0084										
50	N 4507148 025	4507124 564	4507138 465	4507161 839										
	E 461015 0761	461020 2554	461017 7262	461014 2451	4505801 15	461000 2897	460952 8637	460952 1032	460926 9128	460925 1447	460912 7562	460889 2348	460905 3262	
52	N 4506692 247	4506691 565	4506685 275	4506688 796	4506679 342	4506683 636	4506644 364	4506649 567	4506645 429	4506650 491	4506624 552	4506640 759	4506663 899	
	E 461126 7419	461131 6782	461154 1515	461161 3421	461138 7906	461138 2515	461139 6188	461112 2249	461109 3889	461136 7858				
53	N 4506577 763	4506575 579	4506604 873	4506608 526	4506608 069	4506613 245	4506600 337	4506597 334	4506625 03	4506627 772				
	E 461449 4658	461449 9935	461434 7278	461436 4439	461424 8399	461429 9206	461411 9116	461402 431	461428 4099	461438 1599				
54	N 4506693 92	4506699 408	4506697 753	4506703 415	4506708 734	4506710 563	4506703 856	4506730 025	4506739 584	4506713 477				
	E 461783 0549	461782 2847	461806 1627	461806 0975	461806 2019	461841 2573	461841 4638	461805 973						
56	N 4507032 257	4507037 519	4507032 169	4507037 02	4507019 936	4507020 385	4507043 545	4507043 561						

KËRKESË

Shtetasja Imelda Spahiu kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të vdekur të shtetasit Sali (Mikel) Spahiu, i lindur më 14.4.1976, në Sohodoll, Dibër, si dhe caktimin si datë të vdekjes së tij më datë 5.5.2005.

Caktimin si kujdestare të pasurisë së tij bashkëshorten e tij, shtetasen Imelda Spahiu.

KËRKUESE
Imelda Spahiu

KËRKESË

Shtetasja Mirela Balla kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të vdekur të shtetasit Ismail Dervishi, i lindur më 20.3.1963, në Tiranë, me atësi Tefik dhe amësi Satbere, dhe caktimin si datë të vdekjes së tij datën 1.1.1998.

KËRKUESE
Mirela Balla

]

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë